



VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.8(422)

GUSHT 2023

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI ; website: www.VETERANIOBVL.ORG

80 VJETORI I KRIJIMIT



NDEROJMË ZONËN E PARË OPERATIVE VLORË-GJIROKASTËR - MALLAKASTËR

Prof. Asoc. Dr. Bernard ZOTAJ

Mjeshtër i Madh

FAQE 9

LIBRI



DR. NOVRUZ ZEJNATI

SHPENDI TOPOLLAJ, SHEMBULLI ÇMUAR NË MBROJTJE TË ÇËSHTJES KOMBËTARE

FAQE 15

HOMAZH



LAMTUMIRË HALIT BERISHA

Për intelektualin që i përballoi me dinjitet sfidat e jetës, ish anëtar i Këshillit Drejtues Kombëtar të OBVL

FAQE 13

MESAZHI/ Organizatat e Veteranëve duhet të përqëndrohen në misionin e tyre patriotik, larg preferencave personale politike

HISTORIA E LANÇ TË RISHKRUEHET ME VËRTETËSI SHKENCORE

OPINION

MESAZHE OPTIMISTE PËR BASHK(PUN)IMIN E ORGANIZATEVE TË VETERANËVE

Halil RAMA*

Në mesazhin që Kryetari i Komitetit Kombëtar të Organizatës së Veteranëve dhe Pasardhësve të LANÇ të popullit shqiptar "Nderi i Kombit", Prof. Dr. Hulusi Hako u drejtoi anëtarëve të kësaj organizate në vigjilje të 20 korrikut që njihet si "Dita e veteranit", ndër të tjera shprehet për domosdoshmërinë e bashkëpunimit mes dy organizateve të veteranëve: OVP të LANÇ dhe OBVL. Profesori i mirënjohur Hako, i cili gjatë gjithë karrierës së tij është shquar për vizionin bashkëkohor dhe si mishërues dhe përcues i vlerave më të mira njerëzore dhe intelektuale e konsideron koninçidencë të bukur 66-vjetorin e OVP të LANÇ "Nderi i Kombit" me 29 vjetorin e themelimit të Organizatës tjetër si motër, OBVL-së.

VEJON NE FAQEN 3

STUDIMI

"NORA E MIRDITËS" QË I PREU KOKËN DJALIT TË BEGOLLIT

Nga Xhemal MEÇI

Mjeshtër i Madh

FAQE 16

PORTRET

BEDRIE METUKU, NËNA HEROINË, QË LINDI E RRI TI 10 FËMIJË

FAQE 16



• OBVL dëshiron që në vlerësimin e historisë së LANÇ të përqëndroheni në promovimin e asaj, se çfarë heroizmi e vetmohimi është në gjendje të bëjë populli ynë kur e thërret zëri i Atdheut.

Nga Maksim VINÇANI - Nënkrjetar i OBVL

FAQE 3

Dialogu Kosovë-Serbi, në kufinj të ekstremë

Nga Bashkim Hisari

FAQE 8

Aeroporti i Vlorës në vitet 1914 deri në vitet 1940

Neki ÇAKO

FAQE 7

AKTUALITET



Parandalimi i zjarreve, Peleshi takim me prefektët e kryetarët e bashkive

FAQE 10

79-VJETORI

HISTORIA E LAVDISHME E BRIGADAVE 14, 16, 18 DHE 19-TË PARTIZAZE

FAQE 4-7

80-VJETORI

BETEJA E POJSKËS NGJARJE E VEÇANTË NË HISTORINË E LANÇ

Nga Xhuljeta GRACENI

FAQE 6

HISTORIA

BETEJA E DIBRËS, 3-11 PRILL 1941

Nga Sakip CAMI

FAQE 12

OPINION

FILOZOFIA, NJERIU BASHKËKOHOR DHE TREGU I PUNËS

Nga Ferit BAÇA

FAQE 10

SUPLEMENTI "LETRAT"

"PILOTI DHE NJERIU" – PJESE NGA LIBRI "SHQIPONJA E DUKAGJINIT"

Nga Gjin Musa

FAQE 14

80 VJETORI I KRIJIMIT

Nderojmë Zonën e Parë Operative Vlorë - Gjirokastrë - Mallakastër



Prof. Asoc. Dr. Bernard ZOTAJ
Mjeshtër i Madh

Zona e Parë Operative Vlorë-Gjirokastrë-Mallakastër (ZIOp) u krijua me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH-së, më 4 gusht 1943, në Kuç të Kurveleshit. Ajo përbëhej nga komanda dhe shtabi. Komandant i saj ishte kapiten Islam Radovicka dhe komisar toger Bedri Spahiu. Ky formacion në pak më tepër se një vit të ekzistencës së saj (gusht 1943-tetor 1944), përballoi me sukses shumë operacoe lokale të nazizmit gjerman dhe të bashkëpunëtorëve të tij, krahas dy mësymjeve të mëdha të përgjithshme të ushtrisë gjermane, atë të Dimërit të vitit 1943-1944 dhe të Qershorit 1944. ZIOp si formacion luftarak e administrativ ishte unikal dhe i veçantë për shkak të shtrirjes gjeografike, organizimit dhe të funksionimit luftarak e administrativ në përbërje të UNÇSH-së gjatë Luftës Dytë Botërore.

Juridiksioni i Zonës u shtri në dy qarqet Vlorë e Gjirokastrë dhe përfshiu edhe krahinën e Mallakastërës, krahinë me lidhje të ngushta historike luftarake, etnozакonore e kulturore me trevën e Labërisë. Zona mori në vartësi të saj luftarake gjithë formacionet luftarake që ishin organizuar dhe vepronin deri në atë kohë në vartësi të qarqorëve të PKS-së për Vlorën e Gjirokastrën, përfshi edhe formacionet luftarake e ndihmës në Kurvelesh e Mallakastër.

Krahinat e ZIOp kanë luajtur rol të rëndësishëm në plotësimin e detyrave luftarake e administrative nga të cilat vareshin. Sipas direktivave të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH dhe vendimeve të Komandës së Zonës, më 10-11 tetor 1943, u krijuan 5 grupe partizane me nga tre batalione secili. Por pati dhe grupe si Grupi i Tretë i Mallakastërës që kishte katër batalione. Por komanda e shtabi i saj mbajtën në rezervë dhe dy batalione. Kështu Zona kishte gjithsej 18 batalione partizane të organizuar dhe gjithmonë në gatishmëri të përhershme luftarake.

ZIOp, në fushën e organizimit ushtarak, për vetë masën e gjerë të kontingjenteve që zotëronte krahina e Labërisë, Çamërisë, Dishnicës dhe ajo e Mallakastërës, por dhe të mobilizimit të popullit në luftë, shërbeu si burim i pashtershëm furnizimi me kontingjent njerëzor të 7 brigadave partizane të hapura në të gjithë Zonën. Të tilla ishin Br. V, VI, VIII, XII, XIV, XIX dhe XI S, si dhe plotësimin me kontingjente të shumta të brigadave të tjera të UNÇSH-së, si Br. I, II, III, IV, XVI S etj.

Mbi 16.000 djem e vajza u përfshinë në formacionet partizane dhe ranë në fushën e nderit 2130 dëshmorë. Në hapësirën e ZIOp vepronin edhe formacione luftarake të UNÇSH-së, si brigada sulmuese. Komanda e shtabi i ZIOp organizoi dhe ushtroi edhe pushtetin e prapavijave të Zonës si dhe formacionet ndihmëse luftarake të UNÇSH-së, çetat e batalionet territoriale



• Mbi 16.000 djem e vajza u përfshinë në formacionet partizane dhe ranë në fushën e nderit 2130 dëshmorë. Në hapësirën e ZIOp vepronin edhe formacione luftarake të UNÇSH-së, si brigada sulmuese. Komanda e shtabi i ZIOp organizoi dhe ushtroi edhe pushtetin e prapavijave të Zonës si dhe formacionet ndihmëse luftarake të UNÇSH-së, çetat e batalionet territoriale në gjithë hapësirën e saj gjeografike

SHTABI I ZIOp



në gjithë hapësirën e saj gjeografike.

Forcat e ZIOp, nën drejtimin e komandës dhe të shtabit të Zonës, kryen një sërë veprimesh luftarake të rëndësishme. Në shkallë zone u zhvilluan beteja të tilla si lufta e Konispolit, lufta e Libohovës, lufta e

Drashovicës. Pas kapitullimit të Italisë fashiste (1943) forcat e Zonës çarmatosën posta e garnizone të divizioneve italiane "Parma" e "Peruxhia" në Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet, Sarandë, Drashovicë etj.

Në bashkëpunim me brigadat sulmuese që gjendeshin në zonë, komanda e shtabi i Zonës përballuan një sërë operacionesh të pjesshme nazistëve gjermanë, si atë "Eilbote", "Sturm", "Bergkeseel", si dhe dy operacione të mëdha të përgjithshme: operacionin gjerman të dimrit 1943-1944, që ndërmorën nazistët gjermanë me forca të Korpusit XXI e XXII Malor dhe 5.000 forca mercenare, si dhe operacionin gjerman të qershorit 1944, e cila në fazën e dytë të saj i zhvendosi veprimet luftarake në juridiksionin e ZIOp. Pranë shtabit të ZIOp gjatë luftës qëndruan dhe misione ushtarake të vendeve të koalicionit antifashist botëror si anglezë dhe amerikanë.

Pas përballimit me sukses të operacionit të Qershorit 1944, komanda e zonës, në bashkëpunim me brigada sulmuese, organizoi veprimet luftarake dhe çliroi qytetet e Gjirokastrës, Delvinës, Vlorës e Fierit dhe krejt hapësirën e qarqeve e të krahinave që mbulonte ajo. Kështu ZIOp i plotësoi me nder dhe lavdi detyrat që ia ngarkuan.

Lufta e Dytë Botërore, ka qenë një luftë që përfshiu gjithë globin. Bota sot është e qytetëruar, por në kushtet e globalizimit, ajo përsëri i nderon dhe i respekton sakrificat që kanë bërë popujt në luftën për liri dhe pavarësi. Dhe sot ky integrimi në Evropë, kërkon për të gjithë shqiptarët të shkojmë me dinjitet, me formë, me përmbajtje, me dinjitet, por me identitet e përcaktim kombëtar.

Ne në Evropë do të jemi si shqiptarë, me identitetin dhe luftën tonë të drejtë e çlirimtare. Të gjithë duhet të ndjehemi krenar, pasi Shqipëria, kur ka qenë puna për fatet e Atdheut, për dinjitet e identitet kombëtar, nuk ka kursyer as gjenë më të shtrenjtë, gjakun e bijve e bijave të saj, madje në krah të forcave më të përparura të kohës.

Për ZIOp kam mbrojtur disertacion në Akademinë Ushtarake dhe kam shkruar një libër që i bën jehonë kësaj ngjarjeje të lavdishme.

Në këtë 80 vjetor të krijimit të këtij formacioni disi të veçantë për kohën dhe LANÇ të popullit shqiptar, ky formacion i lavdishëm duhet të nderohet dhe të respektohet për kontributin e dhënë dhe për meritat e veçanta.

MESAZH

Organizatat e Veteranëve duhet të përqëndrohen në misionin e tyre patriotik, larg preferencave personale politike

Historia e LANÇ të rishkruhet me vërtetësi shkencore

• **OBVL dëshiron që në vlerësimin e historisë së LANÇ të përqëndroheni në promovimin e asaj, se Çfarë heroizmi e vetmohimi është në gjëndje të bëjë populli ynë kur e thërret zëri i Atdheut. Duke iu dhënë kështu brezave një mesazh të qartë krenarije për sakrificat dhe arritjet e Ushtrisë Partizane, që nëse e do përsëri situata, populli patriot do ta përsërisi sa herë të jetë nevoja**

Nga Maksim VINÇANI*

Nënkryetar i OBVL

Tnderuar miq!
I ngarkuar nga Kryesia e OBVL, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës, ndodhem sot këtu për t'iu përcjellë përshëndetjet e përziera dhe vëllazërore të anëtarëve tanë (veteranë, pasardhës e dashamirës) me rastin e ceremonisë së përkujtimit të 66-vjetorit të krijimit të Organizatës tuaj! Ju urojmë të gjithë anëtarëve të OVP të LANÇ "Nderi i Kombit" festën e tyre, duke besuar në kontributin e mëtejshëm për lartësimin e vlerave të Luftrave të Popullit tonë për liri.

Gjithashtu, si vëllazër e patriotë, ju urojmë shëndet dhe gëzime në familjet tuaja!

Organizata e Veteranëve dhe Pasardhësve të LANÇ "Nderi i Kombit" (Fillimisht Organizata e Veteranëve të Luftës e të Punës) u themelua në vitin 1957. Mbas ndryshimit të sistemit politik, si rezultat i mundësive që dha kriteri demokratik i të shprehurit lirshëm, midis veteranëve, pati diskutime deri në mosdakortësi për qëndrime të caktuara, gjë që solli si rezultat që një grup veteranësh, ish partizanë, personalitete të spikatura të LANÇ, në vitin 1994, morën nisativën dhe formuan një organizatë tjetër të veteranëve, OBVL.



E përbashkëta midis dy organizatave ka qënë, është dhe do mbetet vlerësimi, përkujtimi dhe pro-

movimi i LANÇ; nderimi i dëshmorëve, i pjesëmarrësve në forcat e armatosura, i protagonistëve si dhe familjeve që ndihmuan për atë Luftë.

OBVL dëshiron që në vlerësimin e historisë së LANÇ të përqëndroheni në promovimin e asaj, se Çfarë heroizmi e vetmohimi është në gjëndje të bëjë populli ynë kur e thërret zëri i Atdheut.

Duke iu dhënë kështu brezave një mesazh të qartë krenarije për sakrificat dhe arritjet e Ushtrisë Partizane, që nëse e do përsëri situata, populli patriot do ta përsërisi sa herë të jetë nevoja; por asnjëherë si instrument për vendosjen e një rendi në shërbim të instalimit të ndonjë ideologjie, apo për objektiva politike; por vetëm për mbrojtjen e trojeve nga pushtues të huaj.

Gjithashtu, OBVL mendon se janë krijuar kushtet që të rishkruhet me vërtetësi shkencore

Historia e LANÇ, ashtu siç ka ndodhur. Nderkohë OBVL vlerëson që Organizatat e Veteranëve duhet të përqëndrohen në misionin e tyre patriotik, larg preferencave personale politike. Në fakt, kemi shumë për të thënë midis nesh, por jo në këtë rast, sepse kodi i mikpritjes nënkupton respektin ndaj mikut të ftuar, nga njëra anë dhe nga tjetra mysafiri duhet të njohë dhe të ruajë disa kufij në shtëpinë e mikut. Ne shpresojmë, bile ngulim këmbë që aktivitetet tona të jenë të përbashkëta në organizimet që bëjnë Bashkitë (sigurisht duke ruajtur disa kriteret).

Së fundi urojmë që Organizatat tona t'i kalojnë paragjykimet dhe të bashkohen në Nismën e Federatës Shqiptare të Veteranëve, tashmë të krijuar nga OBVL dhe org. e Veteranëve të Kosovës, duke ruajtur secila Org. autonominë e saj por duke bashkërenditur organizimin për aktivitete të caktuara. Në këtë mënyrë, do të zgjerohet fasha e objektit, qoftë në teritor që të ketë vërtet karakter Kombëta, qoftë në kohë, që nga krijimi i Shtetit Shqiptar e deri më sot. Kështu do t'iu lemë pasardhësve amanetin që të jenë të bashkuar në mbrojtjen e vlerave patriotike të Shqiptarëve, duke vënë në plan të parë interesat atdhetare para interesave të tjera. Ju falenderojmë për ftesën! Ju urojmë vazhdim të mbarë!

*Përshëndetje e Kryesisë së OBVL-së për 66 Vjetorin e OVP të LANÇ "Nderi i Kombit", Tiranë, 20 Korrik 2023

MESAZHE OPTIMISTE PËR BASHK(PUN)IMIN E ORGANIZATEVE TË VETERANËVE

Halil RAMA*

(vijon nga fq.1)

Koincidençë e bukur këtë radhë është edhe 29 vjetori i themelimit të Organizatës tjetër si motër. OBVL-së. Ajo e nisi jetën e saj më 14 korrik 1994, një simotër me arritje të konsiderueshme. Gjejmë rastin ti shprehim urime për ditëlindjen dhe përgëzime vëllazërore.

E drejtuar nga personalitete historike të Luftës dhe persona publikë si Dr. Ymer Dishnica, Gjeneral Rrahman Perllaku, Kolonel Myfit Guxholli e në vazhdim, kjo Organizatë ka dhënë kontributin e saj të vyer në evokimin e vlerave dhe lavdisë së Epopesë së Madhe Kombëtare, shkruan Prof.Hako në pikën 2 të këtij mesazhi (faqja zyrtare në facebook e OVP të LANÇ, 14 korrik 2023). Më tej në pikën 3 të këtij mesazhi, duke u shprehur rreth idesë së artikullit "29 vjet OBVL" të Kryetarit Kolonel Sotir Budina se: "OBVL i bëri thirrje Komitetit Kombëtar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare për bashkim..." (Gazeta Veterani, korrik 2023), Prof Hako ndër të tjera shkruan se: "Mbetemi gjithnjë me po atë ndjeshmëri të lartë dhe besnik të patundur të parimeve të pastra ndaj realizimit të këtij imperativi historik dhe jetik. Ç'të merremi me kushte e sugjerime të pjesshme, kur një rend shoqëror që nisi të ndërtohet me aq shumë mund e sakrificë, me entuziazmin e një populli të lirë e sovran, dëshmoi tërësisht për shkaqe të njohura! Asgjë s'na ndan e skemi ç'ndajmë, përveç atdhetarizmit të thellë, që përshkoi dhe mbeti tipari thelbësor i asaj Lufte..... Jemi dy Organizata Atdhetare me të njëjtën kauzë, objektiva dhe ideale të përbashkëta. Detajet dhe objeksionet për ngjarje e ndodhi le t'ia lëmë historianëve profesionistë.

Mjafton që të punojmë bashkërisht, pozitivisht. Se të gabuarit nuk i ndahet njeriut dhe mbarë njerëzimit historikisht, po nëpërmjet korrigitimit të

garantohet progresi.

Prandaj, vënia në veprim e vullnetit atdhetar, përcaktimi i disa modaliteteve të thjeshta të afrimit, lidhjeve e bashkëpunimit midis të dy organizatave të LANÇ në veprimtari të përbashkëta, deri në orientimin e natyrshëm të zgjedhjeve në bazë e qendër për unifikim, do të pritej si një shtet i madh nga mbarë populli dhe krenimi i 80 vjetorit të Çlirimit të Atdheut do të bëhej sipas identitetit, vlerave e dinjitetit që i takon. Udhëhiqemi nga urtësua popullore:

Bashkimi bën fuqinë! Lulet kanë ngjyrë e aromë të qëndrueshme, shikimet dhe nuhatjet janë të ndryshme për hall dhe hesap të tyre. Kjo normë vepron si midis organizatave, ashtu dhe brenda secilës prej tyre. Kemi thënë 'jemi organizatë pluraliste' dhe kjo tregon e flet shumë. Po uniteti ynë i mendimit dhe i veprimit e ka fushën e vet të përcaktuar qartë dhe nuk lë shteg për ekuivok. Objektivat dhe motivet historiko-atdhetare tonat janë kaq përmbytësore e të fuqishme, sa i kalojnë në plan të dytë ngjarje dhe faktet e veçanta. Po divergime mendimesh janë fakt i hidhur e lehtësisht të montueshme, jo vetëm midis dy organizatave homologe, po dhe brenda secilës prej tyre"...

Kryesia e OBVL përshëndet këtë qëndrim të ri të OVP të LANÇ "Nderi i Kombit". Kjo për faktin se që në deklaratën e parë pas krijimit (27 korrik 1994) kryesia e organizatës sonë do të shprehej se: "Ne duam bashkim dhe angazhohemi totalisht për arritjen e tij mbi parimet e drejta të mirëkuptimit dhe tolerancës ashtu si na takon dhe si i nevojitet Shqipërisë.

Jemi të bindur se të bashkuar do të mbrojmë më mirë traditat luftarake dhe vlerat patriotike të LANÇ, që brezave t'u transmetojmë mesazhin se interesat e atdheut qëndrojnë mbi ato të partive politike, se ato janë të shenjta dhe mbrohen më mirë kur jemi të bashkuar".

(Vijon në faqen 9)

HISTORIA

Më 17 Gusht 1944, në Sheper të Zagories u formua Brigada e XIV S partizane

BRIGADA XIV SULMUESE E UNÇSH, njësia që çliroi qytetin e Gjirokastrës

Br. XIV S zhvilloi veprime luftarake mësymëse në krahinën e Gjirokastrës, në Sarandë e bregdet në kuadrin e Mësymjes së njësive të UNÇSH për çlirimin e qyteteve kryesore të Shqipërisë së Jugut (shih). Në bashkëveprim me një batalion të Br. XIX S, më 18 shtator, çliroi Gjirokastrën. Me një pjesë të forcave në bashkëveprim me Br. XII S (shih) më 11 tetor çliroi Sarandën. Në këtë luftë armikut iu vranë dhjetëra ushtarë, iu zunë 150 robër, ndër ta edhe një komandant hitlerian me gradën kolonel, si dhe një sasi e madhe armatimi e material ushtarak. Me forcat e tjera, në bashkëveprim me Br. XIX S, më 11 tetor çliroi edhe Delvinën. Në luftimet për çlirimin e këtyre zonave, nga Br. ranë 12 dëshmorë. Komisari politik i Brigadës ishte Kahreman Ylli.

GODITJET QË I DHA ARMIKUT BRIGADA E 14 SULMUESE

Më 17 Gusht 1944, në Sheper të Zagories u formua Brigada e XIV S partizane, ku në përbërje të saj u përfshinë grupi i Kurveleshit, grupi i 3 i Mallakstrës dhe grupi i 4 "Çamëria" që bënë pjesë në zonën e I operative Vlorë-Gjirokastrë. Komandanti i brigadës u zgjodh Gjon Banushi dhe komisar Karaman Ylli. Brigadës i ngarkua një sektor i gjerë veprimi që përfshinte Libohovë-Pogon, Lunxhëri-Cepo-Rrozom. Goditjet që i dha armikut brigada e 14 sulmuese, në qarkun e Gjirokastrës e detyruan atë të mbyllej në vendet e fortifikuara në bashkëpunim edhe me forca të tjera partizane ajo nuk e la të qetë armikun. Një nga këto beteja është sulmi mbi kalanë e Borshit dhe forcave armike në bregdetin e Sarandës. Luftimet e ashpra bënë të mundur që forcat partizane të vinin nën kontroll kalanë e Borshit dhe pjesën më të madhe të bregdetit të Sarandës. Gjirokastra që njeh disa

U formua më 17.8.1944 në Sheper të Zagorisë nga një batalion i Grupit I të Kurveleshit, një batalion i Grupit III të Mallakstrës dhe dy batalione të Grupit IV të Çamërisë, gjithsej rreth 559 luftëtarë, që u organizuan në tri batalione e një togë të armëve të rënda. Gjatë zhvillimit të veprimeve luftarake numri i luftëtarëve u shtua në vullnetarë të rinj dhe nga fundi i shtatorit krijoi edhe batalionin IV.



luftime të zhvilluara në qarkun e saj por edhe më gjerë, ato të 2 tetorit 1943 kundër forcave naziste të zhvilluara në urën e Kardhiqit e Manastirin e Cepos, por edhe në kantundin Gjon të Vlorës të zhvilluar nga Batalioni "Asim Zeneli" e batalioni "Halim Xhelo", të

cilët formuan edhe grupin e I-rë partizan të zonës së I-rë operative Vlorë-Gjirokastrë e që zhvilluan një sërë luftimesh si ato të 18 Nëntorit 1943 për çlirimin e qytetit të Gjirokastrës e që banorët gjirokastritë dolën nëpër rrugët e qytetit duke i prituri me shumë mall e dashuri partizanët e këtyre batalioneve, por edhe luftimet e zhvilluara në Përmet e në Këlcyrë dhe në Qafën e Këçokut kundër autokolonës gjermane të shoqëruar me tanke e autobllinda. Por armiqtë që e kishin lakmi Gjirokastrën; e pushtuan përsëri. Kështu më 2 Gusht 1944 Brigada e 8 sulmoi pushuesit nazistë në Gjirokastrë dhe hyri në disa lagje të qytetit. Fill pas veprimeve luftarake në Gjirkastrë, ajo kaloi në krahinën e Konispolit dhe së bashku me grupin e zonës së I-rë operative më 26 gusht çliroi Konispolin.

Nga muaji Shtator 1944, në qytetin e Gjirokastrës ndodheshin 500 forca gjermane dhe 250 xhandarë e ballistë, të cilët ishin vendosur në vendet të fortifikuara dhe zotëruese, siç ishte kalaja e qytetit përveç kësaj garnizoni nazist mbrohej edhe nga mjaft armë zjarri të fuqishme si artileri e mitrolozë të rëndë. Pikërisht në këtë kohë komanda e brigadës 14 Sulmuese mori vendim në bashkëveprim edhe me disa forca të brigadës 19, batalionin Thana Ziko të sulmonte garnizonin armik të Gjirokastrës dhe ti kthente lirinë e humbur 2 herë me çdo kusht qytetit. Gjithashtu u vendos që të goditej edhe garnizoni nazist në Jorgucat që forcat e këtyre 2 garnizoneve të mos kishin mundësi të bashkëvepronin. Më 17 shtator lufta u ndez e ashpër në periferi të qytetit. Armiqtë përballuan me vështirësi sulmet e partizanëve dhe u tërhoqën në pozicione më të fuqishme. Partizanët u futën në qendër të qytetit e në disa lagje ku qëndruan për disa orë. Në mëngjes, ata u tërhoqën e zunë vend në periferi të qytetit. Në 18 shtator të 1944 forcat partizane filluan sulmin e ashpër. Që në minutat e para, beteja ishte e rreptë dhe në afërsi, deri në bomba dore, por shpejt një pjesë e forcave armike u tërhoqën në panik dhe u futën në kalanë e qytetit. Partizanët sulmuan kalanë të cilën e çliruan. Çlirimi i kalasë finalizoi kështu edhe çlirimin një herë e përgjithmonë të gjithë qytetit të Gjirokastrës. Dita e 18 shtatorit 1944 në Gjirokastrën e çliruar valoi fitimtar flamuri i lirisë, prandaj kjo ditë do të përkujtohet edhe në këtë 77 vjetor të këtij viti, si dita e çlirimit të këtij qyteti

Brigada XVI mund të quhet ndryshe edhe Brigada partizane e rinisë

Ushtria partizane ishte një legjion nderi i kombit shqiptar

- **Brigada XVI luftoi kryesisht në trekëndëshin Berat Lushnje-Fier dhe e shndërroi Myzeqenë në një arenë betejash të përgjakshme kundër nazistëve dhe kolaboracionistëve**

Gushti i nxehtë i vitit 1944 mund të quhet edhe muaji i krijimit të Brigadave partizane: Brigadës së 14, 16, 18 dhe 19. Ndërkohë që në gushtin e vitit 1943 ishte krijuar famëmadhja Brigada e Parë.

Brigada XVI u inaugurua më 20 gusht 1944 në Therapel të Skraparit. Ky formacion i fuqishëm i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare vërtet u përrua më 20 gusht, por pagëzimin e zjarrit të betejave e fitoreve partizanët e kësaj Brigade e kishin bërë gjatë viteve të luftës për liri. Ky formacion i fuqishëm i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare vërtet u përrua midis skraparllinjve trima e patriotë të pashembullt, por në përbërjen e vet përfshiu edhe partizane e partizanë, vajza e djem të guximshëm e të sakrificës nga trevat e tjera atdhetare, Myzeqeja, Labëria e Mallakastra.

Brigada XVI u krijua nga bashkimi i ish formacioneve të njohura partizane: grupi i tretë i Skraparit, grupi i tretë i Mallakstrës, grupi i parë i Kurveleshit dhe grupi i Myzeqesë. Përveç 200 partizanëve të Brigadës XVI-të, Myzeqeja u bë burim edhe për Brigada të tjera të Ushtrisë partizane: 52 partizanë myzeqarë u rreshtuan në Brigadën e I-rë, 120 në Brigadën e VII-të, 82 në Brigadën e VIII-të, 70 në Brigadën e X-të etj.

Brigada XVI mund të quhet ndryshe edhe Brigada partizane e rinisë. Ndër 560 partizanet e partizanët e saj, më shumë se 85 përqind ishin në moshë të re, 15-30 vjeçarë dhe rreth 70 prej tyre ishin vajza. Brigada XVI luftoi kryesisht në trekëndëshin Be-

rat Lushnje-Fier dhe e shndërroi Myzeqenë në një arenë betejash të përgjakshme kundër nazistëve dhe kolaboracionistëve. Brigada XVI luftoi me një ushtri armike të mirëpajisur me armatimet më të rënda dhe bandat e bashkëpunëtorëve vendas në mbështetje të tyre.

Brigada XVI ngriti në altar të lirisë 56 vajza e djem të bukur e trima, shumica e të cilëve ranë dëshmorë në lulen e rinisë.

Ndaj është koha të rikujtojmë se çlirimi i atdheut është rezultat i Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare të partizanëve shqiptarë, të organizuar në Ushtrinë Nacional-Çlirimtare.

Është koha të rikujtojmë se në rreth gjashtë vjet u ndeshën në beteja të përgjakshme dy ushtri të pabarabarta. Përmbi makinerinë e rëndë ushtarake të pushtuesve e tradhëtarëve, përmbi topat, tanket e avionët e tyre, luftuan e triumfuan partizanët shqiptarë, të organizuar në ushtrinë e tyre që ushqej e veshmbathej nga kasollet e varfëra të Shqipërisë dhe bujaria e popullit liridashës. Ushtria partizane ishte një legjion nderi i kombit shqiptar.

Faktet flasin se fitorja e LANÇ dhe çlirimi i Shqipërisë janë vulosur me 68 muaj luftë dhe sakrificat e 70 mijë luftëtarëve dhe 28 mijë dëshmorëve.

Lavdi të përjetshme partizaneve dhe partizanëve të Brigadës XVI Sulmuese!

Nderim e mirënjohje të pakufishme partizanëve, çlirimtarëve të Shqipërisë, familjeve të dëshmorëve, veteranëve e pasardhësve të tyre.

79 VJETORI

PESË MUAJ LUFTIME TË PËRGJAKËSHME TË BR. 18 SULMUESE

*Nga kujtimet e veteranit Uke A. Cami**

Kronologji

U formua në Sllatinë të Dibrës më 18 gusht 1944 sipas urdhërit të Shtabit të Pëgjithshëm mbi bazën e tre batalioneve, të Dibrës, Martaneshit sipas urdhërit të Shtabit të Pëgjithshëm mbi bazën e tre batalioneve, të Dibrës, Martaneshit, Çermenikës si dhe të partizanëve të ardhur nga krahina të tjera të vendit.

Në drejtimin e Brigadës në ditën e formimit ishin Esat Ndreu, komandant, vëllai i patriotit dhe luftëtarit Elez Isuf Ndreu, Zëvendës komandant Zoi Themeli, Mico Kallamata komisar dhe Sotir Vullkani zëvendës komisar. Më vonë u bënë ndryshime në komandën e Brigadës. Petrit Dume u bë komandant brigade, Hilmi Causholli, komisar, Xhevdet Petrela, Zëvendës komandant, Teme Sejko, Zëvendës komisar, Milo Qirko Zëvendës komisar.

Gafur Korça ishte komandant i batalionit të parë, Qazim Peshku, komandant i batalionit të dytë, Ajat Rusi, komandant i batalionit të tretë dhe Gafur Mehmeti komandant i batalionit të katërt.

LUFTIMET KRYESORE

• Luftimet e kryera së bashku me Brigadën e V Sulmuese në malin e Korabit kundër forcave gjermane që bënë të dështonte faza e fundit e operacionit gjahu i dhelprave;

• Kryerja e disa aksioneve luftarake kundër automobilitëve gjermane gjatë tërheqjes në rrugën automobilistike Prizren/ Kukës/ Pukë dhe lufta për çlirimin e Kukësit;

• Luftimet përtej kufirit shtetëror për çlirimin e qytetit të Dibrës së Madhe, për çlirimin e Kërçovës dhe të Prizrenit.

PESË MUAJ LUFTIME TË PËRGJAKËSHME TË BR 18 SULMUESE

Me 18 gusht 1944 formohet Brigada e 18 Sulmuese me katër batalione, batalionin e Dibrës, batalionin e Martaneshit, batalionin e Çermenikës dhe batalionin e Ri që u formua ato ditë.

Gafur Korça u bë komandant i batalionit të parë, Rexhep Doda, komisar i këtij batalioni, Ferit Muha nga Bllaca u bë komandant i kompanisë parë në këtë batalion, Uke Cami komisar i kompanisë së parë.

Fill pas formimit Brigada u angazhua në luftime çlirimtare. Me 25 gusht na u dha për detyrë çlirimi i Dibrës së Madhe.


Batalioni i parë u vendos në frontin Bajnisht-Kojnarë, batalioni i katërt u vendos në frontin Bofmollë-Ura e Spiles. Frontet e tjera ishin zënë nga një pjesë e forcave të Divizionit të parë. Pas 24 orë luftimesh forcat gjermane në qytet të ndihmuara edhe nga batalioni "Drini" i komanduar nga Dilaver Dine, u tërhoqën nga Dibra e Madhe. Dibra u çlirua.

Brigada e katërt shqiptaro-maqedonase e drejtuar nga Qemal e Nexhat Agolli dhe ku bënte pjesë edhe kushëri im Esat Cami, mori drejtimin e Strugës dhe më pas të Shkupit.

Brigada e 18 mori urdhërin për të shkuar në drejtim të Kukësit e të Prizrenit, në mbështetje të Brigadës 5 Sulmuese ku Hajdar Dushi kishte hasur rezistencë nga forcat e Muharrem Bajraktarit në Kalanë e Dodës.

Batalioni i parë i komanduar nga Gafur Korça dhe Rexhep Doda nga mesi i natës filloi marshimin në drejtim të Kalasë së Dodës dhe në orën pesë të mëngjesit sulmon Kalanë, nga Kalla, Vlesha e Sllova dhe nga Zall-Kalisi dhe pas pesë orë luftimesh të përgjakshme u muar Kalaja. Një pjesë e mirë e luftëtarëve nacionalistë u kthyen me ne dhe luftuan deri në fund kundër gjermanëve. Këtu kemi parë edhe masakrën më të madhe njerëzore, Hajdar Dushin me 22 shokë të vranë, ndërmjet tyre edhe 2 shoqe partizane, të cilat i kishin xhveshur lakuriq dhe u kishin ngulur nga një hu në prapnicë dhe i kishin mbështetur për shkëmbi. Urrejtja ndaj pushtuesit por edhe ndaj atyre që u shkonin pas si nacionalistë e antikomunistë nuk kishte kufi dhe nuk mund të tregohet. Përsëri njoftohemi se shtabi i brigadës së pestë është në rrezik në fshatin Ujmishtë nga forcat Muharrem Bajraktarit.

Pas rrethimit që i bëme forcave të Bajraktarit e çli-



ruam shtabin e Brigadës së pestë, por nga kjo brigadë kishin mbetur në luftim 60 partizanë, kryesisht të vranë nga forcat e Muharrem Bajraktarit. Ja ku kishte arritur vëllavrasja midis shqiptarëve, antifashistëve dhe antikomunistëve.

Populli i kësaj zone më shumë mbështeti Nacional-Çlirimtarin se sa Muharrem Bajraktarin dhe u rreshtua në Brigadën e 24 kundër gjermanëve.

Në këto momente tablo e luftimeve ishte e tillë: Shtabi i Br18 ishte vendosur në Bicaj, shtabi i Br 5 në Has, ndërsa forcat gjermane dhe mbështetësit e tyre në Kukës e Prizren.

Batalioni parë i Br 18 së bashku me batalionin e Lumës banë një aksion tek kulla e Lumës dhe asgjësuan një repart gjerman që vinte nga Prizreni, ku u kap rob edhe qarkkomandanti i Kukësit.

Batalionit Parë të Br 18 ju dha detyrë të sulmonte Topojanin, Zapodin dhe Dragashin. Në Dragash na u dha urdhëri për të marshuar drejt Kukësit, ku në fshatin Bardhoc bllokua rrugën automobilistike.

Kishim këputur në mes edhe urën dhe qëndronim në pritje për ardhjen e autokollonës gjermane.

Pranë meje ishin Shaqir Shira nga Zall Dardha dhe Jonuz Duka nga Maqellara. I pari hapi zjarr partizani Dine Rama nga Shumbati. Gjermanët pa urë kalimi ishin të detyruar të zbrisnin nga makinat dhe të zinin front në tokë por koha punonte për ne sepse ne ishim të pozicionuar dhe të gatshëm për të qëlluar. Në një darë të hekurit pas katër orë luftimesh, gjermanëve u vjen përsëri ndihma në njerëz, teknikë luftarake e logjistike. Ndërsa partizanëve pas katër orë luftimeve filluan tu mbaronin rezervat, por edhe tërheqja ishte e vështirë.

Midis Përbregut dhe Bardhocit u organizua tërheqja me luftim, por patëm të vranë e të plagosur. U plagosën Met Hajrullai, Azis Asllani etj.

Të nesërmen batalioni parë organizoi një aksion tjetër në fund të fshatit Morin ku asgjësohet plotësisht një kompani gjermane por u vra edhe partizani Eles Mena nga Bllaca. Pas tërheqjes nga Dragashi, batalioni i katërt ishte urdhëruar për të sulmuar kalanë e Prizrenit, ndërsa batalioni i parë do të sulmonte Zhurin. Brigada e pestë do të sulmonte Prizrenin.

Pas gjashtë orë luftimesh Prizreni u çlirua.

Pastaj të gjitha forcat partizane përqëndrohën për çlirimin e Kukësit. Forcat gjermane largohen dhe përqëndrohën në Shkodër.

Ndërsa forcat e Brigadës sonë ndodhen në Lug-

inën e Valbonës në Tropojë, njoftohemi me 29 nëntor se forcat partizane kanë çliruar Shkodrën. Luftëm e vazhduam kundër forcave që komandoheshin nga Halil Alia, Muharrem Bajraktari, Gjon Marka Gjoni. Në përpjekje me forcat e Halil Alisë u vranë 13 partizanë të batalionit të Tropojës.

Më 1 janar 1945 na u dha urdhëri për të kaluar në Mirditë, batalioni i parë dhe batalioni i katërt i Brigadës 18. Batalioni i parë do të kalonte qafën e Malit dhe batalioni i katërt do të kalonte Qafën e Kumbullës. Bota binte papushim dhe kishte arritur lartësinë dy metra. Duke kaluar qafën vdiqën katër partizanë. Tuneli i dëborës bllokohej në çast. Në krye të kollonës ishin Gafur Korça, Rexhep Doda, Albert Papparisto, Ferit Muha. Alberti ishte nga Elbasani dhe nuk ishte mësuar me dimra të tillë. Asnjë shtëpi nuk duket në horizont. Jemi të lodhur e të djersitur. Po na humb edhe shpresa e ndonjë strehimi të afërt. Gjashtëqind partizanë rrezikohen të vdesin në dëborë nga të ftohtit, nga lodhja dhe nga uria. Ky acar ishte edhe më i keq se beteja. Kishim kaluar qindra beteja dhe nuk ishin sprapsur ndërsa ky acar e kjo dëborë ishin të tmershme. Ato po na merrnin jetën ngadalë ngadalë. Papritmas hasi në murin e një avllie. U futëm brenda në kasollen e braktisur dhe ndezëm me shpejtësi një zjarr të madh për të shpëtuar nga ngrirja. Disa metra më larg pamë edhe një shtëpi. Ju drejtuam, pjesa e mbetur, se një kasolle nuk mori vetëm dyqind burra. Ishte ora dy e natës dhe thirrja jonë në këtë natë të acartë nuk dëgjohej. Por pas disa thirrjeve e krismave të njëpasnjëshme u dëgjua një zë burri: Kush jeni? Jemi partizanë, ju përgjigjëm. Hajdeni Bujrum sa të jeni, u përgjigj i zoti i shtëpisë. Jemi shumë or mik. Do tju shpërndajmë në të gjithë fshatin me djemtë e mij, tha burri me bujari. Në shtëpinë e tij u strehua Ferit Lleshi, Hamdi Doda, Pali Carapuli, Sali Hoxha etj. Kështu u shpërndanë dhe kaluan natën të gjithë partizanët. Nuk bahej fjalë për të ngrënë, pasi as fshatarët nuk kishin ç'të hanin për vehte, por vetëm për të futur kokën e për të shpëtuar nga ngrirja e nga vdekja. Pasi dëborë ngriu kalonim mbi dëborë dhe udhëtuam drejt Mallkuqes, Domgjonit, Iballës e Pukës.

Në organizimin e ri të pasluftës Brigada e 18 u caktua të shkonte e të shërbente në Gjirokastrë.

*Veterani Uke A. Cami ka qenë komisar i kompanisë së parë të batalionit të parë të Br.18 S dhe kujtimet e tij i ka përmbledhur në librin me titull „Shpirti ynë lridashës“

80-VJETORI

Ngjarje e veçantë në historinë kombëtare, është tregues i vlerave të kësaj treve trimash mikpritës

BETEJA E POJSKËS NGJARJE E VEÇANTË NË HISTORINË E LANÇ

Nga Xhuljeta GRACENI

Buzë liqeni i Ohrit, pikërisht në një nga vendet më panoramike të tij përgjatë rrugës Qafë Thanë – Pogradec, më 16 korrik 2023, në orën 10. 00 të kësaj date, heshti edhe zhurmat e makinave që kalojnë në këtë aks, në nder të dhjetë trimave të lirisë.

Pikërisht në orën 10.00 më 16 korrik 2023, nisi ceremonia zyrtare, në përkujtim të 80-vjetorit të Betejës së Pojskës, në kujtim të 80-vjetorit të një beteje të rrallë të LANÇ, në kujtim të dhjetë kreshnikëve të pavdekshëm, që ranë pikërisht aty, në shesh-betejën e gjerë, ku vetëm trimat ndeshen dhëmbë për dhëmbë me vdekjen duke i buzëqeshur asaj...

Para obeliskut dhe gjysmëharkut lapidar, ku dhjetë luftëtarët qëndrojnë sup më sup, në prani të dhjetëra qytetarëve të Pogradecit, ishin pjesëtarë të familjeve të këtyre dëshmorëve dhe pasardhës veteranësh të LANÇ, pasardhës të familjeve të luftëtarëve të Batalionit të Mokrës e të Dumresë, si, Sokol Agolli, djali i dibranit trim Nabi Agolli, njërit prej 100 normalistëve që lanë bankat e shkollës me 1 Maj 1943, e dolën në mal për liri. Ai u rreshtua në radhët e Batalionit të Dumresë, më pas me formimin e Brigadës XVII S, rreshtohet në këtë formacion edhe si kuadër drejtues, për shkak të trimërisë e të përvojës në luftime.

Kishin Ardhur nga Tirana 4 nipërit bashkë me bashkëshortet e tyre të zv/komandantit të Batalionit të Dumresë dibranit trim, Siri Kodra. Gjithashtu po enkas erdhi nga Tirana zj. Mira Klosi (vajza e Luftëtares së lirisë Jollanda Xhuvani, komisare e Batalionit II të Brigadës XVII Sulmuese), mbesë e dëshmorit të Pojskës, Ptoleme Xhuvani, anëtar i Qarkorit të PK Elbasan që bëri realitet thënien e tij në një hartim kur ishte student në liceun Francez të Korçës: "...Ah sikur të kisha vdek edhe unë për liri!".

Gjithashtu merrnin pjesë dhe pjesëtarë të familjeve të dy dëshmorëve të Batalionit të Mokrës, dy vëllezërit e Komandantit të këtij Batalioni Reshit Çollaku Heroi i Popullit, dhe djali i Dëshmorit Koli Gusho.

Si në çdo vit, ishin të pranishëm kryetari i OV e Pasardhësve të Veteranëve të LANÇ Dega Pogradec, Bedri Mokri, kryetari i OKDA Pogradec Beshir Pëllumbaj, nënkryetarët, anëtarë të kryesisë dhe anëtarë të tjerë të këtyre organizatave.

Veç tyre, të pa munguar në këtë datë të shenjtë, ishin kryetarët e OKDA Elbasan, Librazhd e Përrenjas, respektivisht Xh. Graceni dhe Ismet Muça, dhe kryetarët e OV dhe Pasardhës të veteranëve të LANÇ të këtyre rretheve Asim Elezi dhe Ruzhdije Hasula.

Ceremoninë zyrtare si çdo vit, e organizoi Bashkia Pogradec, e drejtuar tashmë në mandatin e tij të dytë nga



kryetari Ilir Xhakolli, ku në asnjë rast nuk mungojnë dhe përfaqësues të shumtë të Pushtetit Vendor të kësaj bashkie dhe Prefekturës së Korçës, si Kryetarja e Këshillit Bashkiak, n/kryetarja e bashkisë, Entela Gusho që prezantoi aktivitetin, si dhe nga Institucioni i Prefektit, Qarku Korçë. I pranishëm ishte edhe kryetari i PS Pogradec, z. Erion Thëngjilli.

Fjalën e rastit e mbajti Kryetari i OKDA Pogradec, dhe më pas përshëndetën Seit Çollaku vëllai i Heroit të Popullit Reshit Çollaku, e të tjerë.

Një përshëndetje të veçantë bëri Kryetarja e OKDA Elbasan, Xhuljeta Graceni, e cila nënvizoi traditën e bukur për mirë-organizimin në çdo vit, jo vetëm në përvjetorë të përkujtimit të kësaj beteje. "Kam plot 25 vjet rresht që vij në përkujtim të kësaj ngjarje. Tradita e krijuar dhe lidhja e ngushtë midis organizatave tona për ne, ka zhvlerësuar edhe ftesat.", -theksoi ndër të tjera ajo.

Më pas, me ndjesi mirënjohje dhe respekti ajo përshëndeti popullin e Pogradecit, Mokrës e Pojskës që si

dje në luftë edhe sot pas lufte, në përkujtime i kanë portat dhe zemrat hapur... Po me këtë ndjesi të thellë, ajo falenderoi Kryetarin e Bashkisë Pogradec që është një model për kryetarët e rinj në moshë, në qarkun tonë, që di të nderojë gjakun e derdhur për liri dhe atë luftë të lavdishme që na bën krenar, sepse u rreshtuam në kahun e duhur të historisë përkrah fitimtarëve. Në asnjë rast dhe nga asnjë veprimtari e OKDA e OV të LANÇ që unë kam ndjekur në Pogradec, kryetari i bashkisë z. Ilir Xhakolli kurrë nuk largohet pa përfunduar veprimtaria. "Mbështetja juaj është inkurajim, forcë dhe motivimi i duhur. Për shokët tanë këtu në Pogradec. Ai di të respektojë dhe rezervojë kohën e duhur e të plotë kur merr pjesë në këtë ceremoni. Ky është nderim dhe vlerësim për organizatat tona. Është ai nderim e vlerësim që bëjnë edhe vendet e qytetëruara të Evropës që u përfshinë në Luftën II Botërore, kundër nazi-fashizmit, bishës më të egër që ka njohur Planeti Tokë." Pas ceremonisë zyrtare, për të gjithë të ftuarit, Kryetari i Bashkisë Pogradec, z. Ilir Xhakolli, edhe këtë vit, shtroi një banket të bollshëm mikpritjeje, si një tjetër vlerë e lartë e tij, dhe e trevës ku ai lindi, u rrit dhe drejton me përkushtim.

Beteja e Pojskës, kjo ngjarje e veçantë në historinë kombëtare, është tregues i vlerave të kësaj treve trimash mikpritës!

Brigada e 'Vëllazërimit' të partizanëve shqiptarë, minoritarë grekë dhe italianë

Brigada XIX Sulmuese Partizane u krijua në Theollogo, më 30 gusht të vitit 1944. Në Brigadën XIX u rreshtuan partizanë të batalioneve "Pandeli Boçari", "Thoma Lulo", "Çamëria", "Thanas Ziko" dhe "Mateoti" me një efektiv rreth 800 luftëtarë.

Brigada zhvilloi luftime të ashpra kundër nazistëve gjermanë dhe bashkëpunëtorëve të tyre vendas, duke u shkakuar atyre humbje të mëdha dhe duke i fituar këto beteja me gjak e sakrificë. Të tilla qenë betejat në Konispol, Delvinë, Qafë Botë, Muzinë, Pec, Zminec, Stugar, Dhrovjan, Libohovë, Qafë e Kiçokut e tjera. Të paharruar do të mbetet lufta frontale e 55 ditëve për mbrojtjen e Konispolit dhe heroizmi i partizanëve të Brigadës XIXnë çlirim dhe qyteteve Delvinë, Sarandë dhe Gjirokastrë.

Kjo Brigadë i dha Luftës Nacional-Çlirimtare dhe dërgoi në Panteonin e Lirisë rreth 100 dëshmorë.

Brigada XIX u krijua në gjirin e këtij populli dhe të kësaj krahine që lirinë e kishte dhe e ka të shenjtë dhe që nuk i është trembur kurrë betejave për ta fituar e mbrojtur atë.

Kjo krahinë i ka dashur, u ka dhënë strehë, i ka ushqyer e veshur me fanella leshi të bagëtive të pakta që kishte dhe i ka mbështetur partizanët shqiptarë me të gjithë fuqinë e zemrës dhe të mendjes.

Kjo krahinë e ka pasur për nder që për disa dekada ka mbajtur emrin e nderuar zona e Partizanit. Ky emër simbolik i ka bërë nder krahinës, por edhe krahina ka nderuar partizanët shqiptarë e minoritarë që luftuan për çlirim dhe atdheut të tyre të përbashkët, Shqipërisë.

Brigada XIX sulmuese është quajtur ndryshe edhe Brigada e "Vëllazërimit". Partizanët shqiptarë u rreshtuan krah për krah me vëllezërit e tyre minoritarë grekë dhe luftuan bashkarisht edhe me partizanët italianë të batalionit "Mateoti".

Rrallë gjen një rast tjetër ku vëllazërim-it të partizanëve të tre kombësive të ndryshme: shqiptarë, grekë dhe italianë. Kjo dëshmon se antifashizmi është një ndjenjë universale, një vlerë dhe pasuri e të gjithë popujve.

Ushtria Nacional-Çlirimtare dhe Lufta Nacional-Çlirimtare ishin një uragan i fuqishëm, faktori vendimtar ekskluziv që siguroi fitoren mbi nazi-fashizmin dhe ko-

laboracionistët.

Sot, në 79 vjetorin e çlirimit të Shqipërisë nga partizanët shqiptarë, Lufta Nacional-Çlirimtare shkëlqen më tepër se kurrë si një ndër stolitë më të vjera të popullit shqiptar.

Lufta dhe vepra e Brigadës XIX është një ndër veprat më të bukura të popullit të kësaj krahine dhe të bashkëpunimit vëllazëror midis shqiptarëve e minoritarëve grekë.

Në miqësinë e hershme, në luftën e përbashkët për liri, në ndjenjat dhe vlerat antifashiste, në përpjekjet e përbashkëta për të ndërtuar mirëqenien dhe paqen, i ka rrënjët bashkëpunimi, marrëdhëniet, respekti, fqinjësia dhe miqësia midis midis dy popujve tanë në ditët e sotme.

Minoritarët grekë gëzojnë të njëjtat të drejta si vëllezërit e tyre shqiptarë dhe emigrantët shqiptarë jetojnë në Greqi si në shtëpinë e tyre. Të dy këto komunitete po shërbejnë si ura miqësie e fqinjësie midis vendeve tona. Është detyra jonë, e parlamenteve dhe qeverive të të dy vendeve, të punojmë pa u lodhur për t'i shërbyer forcimit të kësaj miqësie.

DOSSIER

Si realizoheshin fluturimet drejt Romës, Gjirokastrës e Tiranës dhe sa ishte kosto! Po sot?

Aeroporti i Vlorës në vitet 1914 deri në vitet 1940



nisë puna edhe për ndërtimin e terminalit me sipërfaqe 1800 metra katrorë. Aeroporti i Vlorës, një investim mbi 100 milionë Euro, pritet që të hapë një mijë vende pune të reja, do të ulë çmimet e biletave dhe do ta kthejë Vlorën në portën më të rëndësishme turistike të rajonit dhe do të jetë aeroporti i tretë në vend ku fluturimet do të jenë transoqeanike. Gjithashtu Aeroporti i Vlorës do të jetë edhe baza për flotën e avionëve "Air Albania", ndërsa për herë të parë aty do të ketë një zonë të veçantë për mirëmbajtjen e avionëve, një shërbim i ri i kërkuar nga kompani të huaja, i cili do të përkthehet në të ardhura dhe vende pune shtesë për zonën. Mbetet për tu parë realizimi i këtij projekti përfundimi i tij si dhe realizimi i politikave ekonomike për çmimet lou – kost për tu ardhur sa më shumë në ndihmë xhepave të qytetarëve si dhe realizimit të zhvillimit të turizmit për vjeljen e të ardhurave dhe rritjen e mirqënjes së popullatës.



Neki ÇAKO

Vëndi ynë, Shqipëria ka një histori relativisht të hershme të transportit civil e ushtarak ajror. Fluturimet e para janë realizuar në Shqipëri për qëllime ushtarake, e më pas në vitet '20 ka nisur të zhvillohet aviacioni për transport civil. Fillimisht, ishin italianët që pushtuan Vlorën në fundin e vitit 1914, që ngritën edhe një kamp aviacioni për qëllime ushtarake, që përveç avionëve të zakonshëm përfshinte edhe një bazë hidrovollantësh. Në nëntor të vitit 1924, (kur nga vendi ishin larguar ushtritë e huaja) qeveria shqiptare nënshkroi një marrëveshje koncesioni 10 vjeçar me kompaninë gjermane "Lufthansa". Në bazë të kësaj marrëveshjeje u krijua shoqëria ajrore shqiptare me emrin "Adria Aero Lloyd". Nisja e zbatimit të kësaj marrëveshjeje u shoqërua nga ndërtimi pak muaj më vonë i fushës së parë në kryeqytet që do të përdorej për uljet dhe ngritjen e avionëve. Kjo fushë u ndërtua në zonën e Shallvareve, me sipërfaqe 400 me 200 metra dhe destinacionet e brendshme ishin Vlora e Shkodra. Tre vite pas nisjes së funksionimit, shoqëria "Adria Aero Lloyd" u ble prej zyrës së Aviacionit Civil të Trafikut të Ministrisë së Ajrit të Italisë. Kjo solli edhe zgjerimin e fluturimeve drejt qyteteve të tjera si Elbasani, Gjirokastra, Korça apo Peshkopia. (foto mëposhtë: biletaria e zyrës së aviacionit në Tiranë) Në vitet '30 -'40 transporti ajror i brendshëm mori një hov të madh, lidhur kjo me faktin se u ndërtuan aerodrome thuajse në të gjitha qytetet kryesore. Në këtë periudhë, Shqipëria rezultoi si ndër vendet e rralla në botë që kishte më të zhvilluar transportin e brendshëm ajror sesa format e tjera të transportit. Sa i përket Vlorës, në vitet '40, nga 'aeroporti' i këtij qyteti zhvilloheshin tre linja fluturimesh: Vlorë-Gjirokastrë ku biletat kushtonte 11 franga ari për persona, Vlorë-Romë që kushtonte 90 franga ari për person dhe Vlorë-Tiranë 17 franga ar.

A do të jetë gati fluturimi i parë nga Vlora në fund të vitit 2024? Sa do të ndikojë në uljen çmimeve dhe lehtësimin e lëvizjes së njerzëve! Po transport ndër qytetës brënda vëndit a do te ketë si dikur?

Fluturimi i parë në Aeroportin e Vlorës pritet të bëhet në fund të vitit 2024. Nga një takim me operatorët turistikë në Vlorë, në vitin 2022 kryeministri i vëndit tha se punimet në aeroportin e Vlorës kanë ecur me ritme shumë të mira nëse nuk ndodh asgjë e papritur fluturimi i parë do të mbahet në dhjetor të vitit 2024. Në qytetin bregdetar të Vlorës, është rritur edhe kërkesa e turistëve për të vizituar këtë vend. "Vlora sot është një pasqyrë e një transformimi që ka filluar të prodhojë ekonomi. Por kjo është edhe një sfidë për të pasur më shumë mundësi, kapacitete dhe për të pasur edhe shërbim më të mirë. Faza e parë e punimeve të pistës në aeroportin ndërkombëtar të Vlorës ka përfunduar. Pista 3.2 kilometra është hapur krejtësisht, pritet të nisë puna për ndërtimin e godinës, ndërsa kulla e vrojtimit, rreth 40 metra e lartë do të jetë ajo që do të marrë formë e para. Po vitin tjetër do të



OPINION

Marrëveshjet e deritashme mes Kosovës e Serbisë asnjëherë nuk janë implementuar plotësisht

Dialogu Kosovë-Serbi, në kufinj të ekstremë

Nga Bashkim Hisari

Problemet e shoqërisë kosovare janë të mëdha, të thella, komplekse dhe kanë historinë e tyre. Aktualisht, regjimi autokrat në Serbi me presidentin Aleksandar Vuçiq, po përpiqen të shfrytëzojnë çdo mundësi për konfrontime me shqiptarët. Duke manipuluar me serbët dhe mbështetur grupet e tyre kriminale në Veriun e Kosovës akuzojnë shqiptarët dhe i bëjnë përgjegjës për të gjitha problemet. Te pala serbe nuk ka vetëdije dhe forcë etike, aftësi të forta praktike politike për t'i tejkaluar problemet.. Obligimet janë marrë në mënyrë selektive dhe në përputhje me interesat e tyre të njëanshme. Dialogu dhe arritja e një marrëveshjeje që do të rezultojë me njohje reciproke nuk ka alternativë për të vendosur paqen e përhershme, stabilitetin afatgjatë dhe parandalimin e incidenteve. Kosova nuk mund të durojë më të jetojë në konflikte të papërfunduara dhe të ngrira.

Gjendja e sigurisë në katër komunat me shumicë serbe në Kosovë, vazhdon të jetë e tensionuar. Format e deritashme të dialogut për të gjetur zgjidhjen e problemeve në marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk po japin rezultatet e pritura.

Në vend të dakordimit, zgjidhjet po zhvarriten. Janë hapur kriza të reja që mund të çojnë në konflikte rajonale. Nga jashtë, ndonjëherë duket sikur është humbur mundësia për shtensionimin e situatës. Aktualisht, shumë subjekte po angazhohen që tensionet të vihen nën kontroll, të mos lejohet të shpërthejë dhuna dhe të gjendet zgjidhje për çështjet shumë komplekse në mes shqiptarëve dhe serbëve. Tanimë çdo gjë është e çartë. Koha rreth taktikave, akuzave të ndërsjella dhe e zvarritjeve rreth Kosovës po skadon.

Komuniteti ndërkombëtar po e humb durimin dhe po kërkon që sa më shpejtë të gjendet rrugëdalje. Ndërkombëtarët nuk po pranojnë më të jenë vëzhgues në "taktikat e vonësive". Nëse palët nuk do të jenë partnerë konstruktivë në shtensionim të situatës, atëherë Kosova dhe Serbia do të kenë pasojë. Pavarësisht që ka disa sinjale pozitive, shtensionimi i situatës në Veri të Kosovës ende ka ngelur në gjysëm të rrugës.

Marrëveshjet e nënshkruara mes Kosovës e Serbisë asnjëherë nuk janë implementuar plotësisht. Nënshkruarit e marrëveshjeve në mënyrë selektive kanë marrë obligime në përputhje me interesat e tyre të njëanshme. Zgjidhje politike ende nuk ka.

Si përgjigje, BE dhe SHBA vendosën masa ndëshkuese, siç u tha, të përkohësishme. Por, edhe pas zotimit të



Qeverisë së Kosovës për shtensionime, situata në atë pjesë vazhdon të jetë nën masa.

Kohë më parë, i dërguar i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë-Serbi, Miroslav Lajčak, me zëvendëskryeministrin e Kosovës Besnik Bislimi, u dakorduan për zbatimin e masave që çojnë në depërshkallëzimin e situatës. Nga Qeveria e Kosovës u kërkua publikisht të tregojë gatishmërinë e saj për të kontribuar në shtensionimin e situatës. Menjëherë të reduktohet prezenca e policëve që janë në apo në afërsi të ndërtesave, demonstruesit serbë që ndodhen para objekteve komunale të tërhiqen njëkohësisht me largimin e policisë së Kosovës, kryetarët shqiptarë që kanë fituar mandatet në zgjedhjet e mbajtura në prill të këtij viti, të cilat i kanë bojkotuar serbët, përkohësisht t'i kryejnë detyrat në lokacione alternative jashtë objekteve të tre komunave dhe të organizohet mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme në Veri të Kosovës.

Në takimin e fundit të kryenegociatorit të Kosovës në dialogun me Serbinë, Besnik Bislimi, në Bruksel, me ndërmjetësuesin e këtij procesi, Miroslav Lajčak, është diskutuar për katër tema: plani i sekuencimit të Marrëveshjes Bazë, termat e referencës për monitorimin e Marrëveshjes Bazë, termat e referencës për zbatimin e Deklaratës për personat e pagjetur, dhe për Marrëveshjen për energjinë.

Është arritur edhe pajtimi për aneksin e zbatimit të Marrëveshjes së Ohrit. Kryeministri i Kosovës Albin Kurti deklaroi se Kosova ka nisur t'ua hapë rrugën për zbatimin e marrëveshjes së arritur me BE për shtensionim të situatës dhe se të gjitha do të finalizohen brenda një afati të shkurtër.

Në rrugën drejtë normalizimit të marrëdhënive, diplomatët ndërkombëtarë vazhdimisht theksojnë rëndësinë e dialogut, kërkojnë zbatimin e shpejtë të marrëveshjeve për të cilat palët tashmë kanë rënë dakord me marrëveshjet evropiane të nënshkruara në Bruksel dhe me marrëveshjen e Ohrit, duke përfshirë këtu edhe themelimin e Asociacionit të Ko-

munave me shumicë serbe në Kosovë. Por, ndonëse marrëveshjet për sundimin e ligjit, siguri e qetësi në Veri nuk kanë alternativë, vullneti politik për shtensionimin e situatës është i diskutueshëm.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq duke zbatuar fushatën e frikësimit të serbëve të Kosovës po shfrytëzon çdo mundësi për konfrontim me shqiptarët dhe me kryeministrin e Kosovës Kurti, për t'ua ngarkuar atyre të gjitha problemet e shoqërisë kosovare dhe përgjegjësinë për tensionet e krijuara.

Për të qetësuar gjendjen dhe për

Kuvendit të Kosovës, ku pas një fjalimi të kryeministrin Kurti në seancën e rregullt të Kuvendit, ku ai foli për marrëveshjen e fundit, për shtendosjen e tensioneve në Veri të Kosovës dhe për gatishmërinë e Kosovës që ta shtensionon situatën, me ç'rast ndodhi edhe rrahje mes shumicës dërmuese të deputetëve si nga opozita si nga pozita, ishin të turpshme dhe në dëm të madh të institucioneve të Kosovës. Ato e komplikuan situatën, po e largojnë Kosovën nga rruga demokratike për zgjidhjen më të shpejtë të problemeve në raport me Serbinë dhe po e distancojnë nga aleatët ndërkombëtarë.

Përderisa kryeministri Kurti kërkon zbatimin e plotë dhe pa kusht të ligjeve dhe deklarave se "Nuk mund t'i dorëzoj shtetin demokratik milicisë fashiste serbe në Veri të Kosovës", liderët politikë serbë, Aleksandar Vuçiq, Ivica Daçiç dhe Aleksandar Vulin, trashëgimtarët e drejtpërdrejtë të frymëzuesve dhe organizatorëve të luftërave në ish Jugosllavi, Vojislav Sheshel, Slobodan Millosheviq dhe figurave të tjera më negative në politikën serbe, glorifikojnë krimet dhe kriminelët e luftës. Ata nuk po e ndalin qasjen e tyre destruktive dhe hysterinë antishqiptare. Vuçiq, Daçiç dhe Vulin ishin shërbëtarë besnikë ndaj shefave të tyre që me dhunën më brutale, qëndrime ç'njerëzore e anti-civi-



të gjetur zgjidhje për normalizimin e marrëdhënive shqiptaro-serbe, Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, zhvilloi një sërë aktivitete. Pas takimit me përfaqësuesin e lartë të BE-së për politikën e jashtme, propozoi një konferencë të përbashkët të liderëve të Kosovës dhe Serbisë me zyrtarët e BE-së dhe SHBA-s. Bëri të ditur se ua ka dorëzuar një draft të Asociacionit të komunave me shumicë serbe, presidentit francez Emmanuel Macron dhe kancelarit gjerman Olaf Scholz. Zhvilloi takime informale dy-ditore në pesë vendet e Ballkanit Perëndimor. Në Tiranë organizoi një takim informal të liderëve të Ballkanit Perëndimor me komisionerin e BE për Zgjerimin dhe Fqinjësinë Oliver Varhelyi. Por, kryeministri i Shqipërisë Rama anuloi takimin e përbashkët të Qeverisë së Shqipërisë me atë të Kosovës në Gjakovë. Më vonë, gjatë vizitës së kryeministrin Rama në Prishtinë, kryeministri i Kosovës Kurti nuk u takua me te. Derisa disa udhëheqës të Ballkanit Perëndimor u takuan në Tiranë me komisionerin e BE Varhelyi, kryeministri Kurti, ka qenë në ishullin grek të Kretës, për një konferencë mbi Ballkanin Perëndimor. Disa qëndrime të Kurtit për Veriun, mosbashkëpunimin e mjaftueshëm me aleatët ndërkombëtarë dhe refuzimet e tij për takimet me liderët e rajonit, po vlersohen si të dëmshme dhe humbje e rastit të mirë për bashkëpunim dhe shtensionimin e situatës. Ngjarrjet e fundit që ndodhën brenda

lizuese përhapnin urrejtje dhe të gjitha të këqiat. Me çfarë do të merreshin ata sot, përpos me kontrabandë me drogë, armë, plaçkitje, korrupsion, me keqpërdorime të pozitave zyrtare, me orekse hegjemoniste ndaj Kosovës. Për të ruajtur pushtetin, këta autokratë etnonacionalistë manipulojnë me serbët duke përhapur gënjeshtër dhe krijuar probleme. Palajmërojnë se do ti kthejnë forcat e armatosura serbe në Kosovë, intensifikojnë presionin duke rritur gatishmërinë luftarake të forcave të armatosura dhe duke organizuar manovra provokuese afër kufirit me Kosovën. Inkurajimi për vendosjen e barrikadave dhe mos reagimi kundër sulmeve agresive të serbëve ndaj policëve të Kosovës dhe paqëruajtësve të KFOR-it, po shërbejnë si mbështetje për afrimin e tyre me Rusinë.

Edhe pse kaluan 24 vite nga lufta, në Kosovë ende ka shumë çështje të diskutueshme. Armiqësia është ende prezente.

Kosova në asnjë mënyrë nuk duhet të lejohet që të shpërthejë dhuna. Nga aleatët e saj duhet të kërkojë të bëjnë më shumë presion për t'u arritur një marrëveshje për të zgjidhur situatën; të bëjnë një luftë diplomatike dhe të pranojnë kërkesat që i kanë shtruar negociatorët ndërkombëtarë, sidomos SHBA si aleat i dëshmuar me rolin e saj thelbësor në ndalimin e spastrimit të egër etnik të popullatës shqiptare në Kosovë nga regjimi serb, në çlirimin e vendit, njohjen e pavarësisë dhe në inkurajimin për ecjen përpara në proceset demokratike në Kosovë.



EDITORIAL

MESAZHE OPTIMISTE PËR BASHK(PUN)IMIN E ORGANIZATEVE TË VETERANËVE



HALIL RAMA*

(vijon nga fq.3)

KOHA PËR KOMPROMISIN E SHUMËKËRKUAR

Kjo frymë e bashkëpunimit ka mbizotëruar pothuajse në veprimtarine e OBVL për afro tri dekada, që nga themelimi i saj. Kujtojmë me këtë rast se para tetë vitesh, Heroi i Popullit dhe Nderi i Kombit, Rrahman Parllaku, në emër të Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar (OBVL) u drejtoi një promemorie krerëve më të lartë të shtetit (ish-Presidentit të RSH, Bujar Nishani, ish-kryetarit të Kuvendit, Ilir Meta, dhe Kryeministrit Edi Rama, si dhe kryetarëve të partive parlamentare, ku argumentonte domosdoshmërinë e unifikimit të qëndrimeve në funksion të integritimit euroatlantik të vendit.

Apeli i gjeneralit legjendë bëhej në një kohë kur klima politike në vend ishte tejet e tensionuar. “Në moshën time të thyer, (atëhere 97-vjeçare), përballë revanshit të nostalgjikëve të diktaturës komuniste dhe ekstremistëve pa fre të të dyja palëve, e ndjej si obligim t’ju bëj thirrje, që t’i riktheheni arsyes së shëndoshë, për të realizuar pajtimin kombëtar, aq shumë të dëshiruar nga shqiptarët e të gjitha kohërave”, shkruante gjeneral Parllaku në promemorien e tij para tetë vitesh.

Po ashtu anëtari i kryesisë së OBVL, shkrimtari i mirënjohur Shpendi Topollaj, njëherësh kryetar i Degës së OBVL të qarkut Durrës, në artikullin e botuar në gazetën “VETERANI” (Nr.3(393), Mars 2021, duke argumentuar domosdoshmërinë e bashk(pun)imit, ndër të tjera shkruan se: “Asgjë esenciale nuk i dallon programet dhe qëndrimet e këtyre dy organizatave në çështjet kardinale. Po ta shohësh në retrospektivë, dhe të analizosh të gjitha fjalimet, artikujt, librat dhe intervistat e tij, gjatë gjithë kohës që OBVL - në e drejtoi Heroi i Popullit dhe Nderi i Kombit, gjeneral Rrahman Parllaku, dhe në vazhdim të tjerët pas ndarjes së tij nga jeta, lehtësisht do të konstatohet krenaria për lavdinë e Luftës Nacionalçlirimtare dhe veneracioni për të gjithë ata djem e vajza që



trimërisht dhanë jetën për liri.

Të dyja gazetatat “Veterani” dhe “Kushtrim brezash”, që këto organizata periodikisht nxjerrin apo të gjitha veprimtaritë përkujtimore që janë zhvilluar, kanë përkujtuar e glorifikuar me të drejtë të njëjtat beteja, po ato çeta, batalione, Brigada, Divizione e Korparmata, drejtuesit e tyre dhe po ata dëshmorë e heronj.

Të dyja organizatat, Luftën Nacionalçlirimtare e konsiderojnë më të lavdishmen pas atyre të Skënderbeut dhe manifestojnë respektin dhe vlerësimin më të madh për ndihmën e dhënë nga forcat aleate dhe rolin e rëndësishëm që ata luajtën në këtë luftë. Po ashtu, të dyja këto organizata, theksojnë sakrificat e jashtëzakonshme që bëri populli ynë gjatë kësaj lufte dhe kontributin e tij në fitoren përfundimtare. ...Të dy organizatat përkrahën njëllë luftën e UÇK - së. Tani lind pyetja se ku qëndron ajo që i ndan këto organizata? Te vlerësimi i figurës së Enver Hoxhës, te pozicioni i organizatave nacionaliste, ku kryesore qe Balli Kombëtar, te fati i komandantëve dhe komisarëve gjatë dhe pas lufte, te miqësia me jugosllavët dhe sovjetikët, te çështja e Kosovës apo te data e çlirimit. Të gjitha këto janë punë historikanësh, sikurse edhe ne mund të diskutojmë gjatë, ashtu sikurse mund të ketë edhe mendime krejt të ndryshme. Se ato s’janë tjetër, veçse pasoja të zhvillimeve politike, ideologjike, sociale, ekonomike të brendshme dhe të jashtme, për të cilat askush nga ne nuk mund të fajësohet. Atdheun të gjithë e duam njësoj. Nuk duhet harruar se qysh atëherë, në botë, por edhe në Shqipëri ka rrjedhur shumë ujë; koha e gjatë që ka kaluar (se nuk janë pak afro tetëdhjetë vjet), ka qenë mëse e mjaftueshme, si për të krijuar sekush bindjen e tij, ashtu edhe për ta fashitur mospajtimin.

Sot ne jemi miqësuar dhe kërkojmë të na pranojnë në aleanca shtetet dhe pinjollët e atyre që na sulmuan me avionë, tanke e topa, që na vranë, na dogjën e na plaçkitën, dhe nga ana tjetër i bëjmë karshillëk vëllezërve të të njëjtit gjak. A nuk tingëllon si paradoksale kjo? Si do na dukej sikur në Francë

fjala vjen, ende të vazhdonin konfliktet dhe stigmatat midis zhirondeve të moderuar dhe jakobinëve të Robespierit, paçka se këta e kishin përfunduar misionin qysh në fund të korrikut të vitit 1794?

Për njerëzit e mençur nuk mund të vazhdohet në pafundësi kështu. Evropa i ka kapërcyer me kohë ndarjet e tilla. Mjaft me armiq imagjinarë. T’i shtrijmë dorën e miqësisë njëri - tjetrit. Dhe për këtë, mos duhet ta marrim ne së pari, mbrojtësit e vlerave të luftës famëmadhe Nacionalçlirimtare, nismën e mirëkuptimit, duke dhënë shembullin se fare mirë mund të jemi në unitet, edhe pse mund të kemi pikpamje jo të njëjta për çështje të veçanta? Duke i shkrirë në një të vetme dy organizatat e veteranëve të Luftës, a nuk do të qe një akti i madh fisnikërie e pajtimi kombëtar, një shërbim i vyer patriotik ndaj popullit e vendit tonë të shtrenjtë, kur ai ka kaq nevojë për dashuri e mirëkuptim? Dhe për një shembull. Mesa di, synimi për bashkim është fiksuar edhe në statutin e OBVL - së dhe i ndjeri dhe njerëzori Rrahman Parllaku e ka shprehur disa herë, gjë që sot mund ta marrim edhe si një amanet të tijin...”.

Po në këtë frymë është edhe përshëndetja që nënkryetari i OBVL Maksim Vinçani, në emër të kryesisë së kësaj organizate, i drejtoi OVP të LANÇ “Nderi i Kombit” në 66-vjetin e “Ditës së veteranit”, duke e konsideruar domosdoshmëri dhe imperativ të ditës realizimin e bashk(pun)imit mes dy organizatave tona të veteranëve (Përshëndetje kjo që nuk u lexua në këtë ceremoni nga të ftuarit, për shkak të vendimit të organizatorëve që të mos bëheshin përshëndetje).

BASHKIMI NË FEDERATËN SHQIPTARE TË VETERANËVE

Një vit e gjysëm më parë, Organizata e Bashkuar e Veteranëve (OBVL) dhe Organizata e Veteranëve të LANÇ të Kosovës, mbi bazën e një programi të përbashkët krijuan Federatën Shqiptare të Veteranëve të Luftërave për Liri e Pavarësi të popullit shqiptar.

Krijimi i Federatës Shqiptare të Veteranëve u finalizua me një aktivitet të rëndësishëm në kuadrin e 14-vjetorit të pavarësisë së Kosovës. Pas një pune intensive gati trevjeçare, OBVL të Shqipërisë, trashëguese e denjë e themeluesve dhe drejtuesve të saj: Dr.Ymer Dishnica – “Nderi i Kombit” e gjeneral Parllaku- “Heroi i Popullit” dhe Organizata e Veteranëve të LANÇ të Kosovës, (që kishin finalizuar krijimin e Federatës Shqiptare të Veteranëve të Luftërave për Liri), ia dolën të realizojnë dhe promovojnë Filmin dokumentar: “FADIL HOXHA-ARKITEKT I KOSOVËS SË LIRË”.

Fokusi i kësaj Federate, në përbërje të së cilës janë Organizata e Veteranëve të LANÇ të Kosovës dhe OBVL të Shqipërisë, janë veprimtaritë e përbashkëta, me synim edukimin atdhetar të rinisë, nisur nga tradita shekullore e popullit shqiptar, nga përvoja dhe programet e Federatave Botërore e Europiane të Veteranëve, si dhe në pikëpamjet e përbashkëta programore, të fokusuara në organizimin e veprimtarive të përbashkëta për: mbrojtjen e vlerave historike të popullit tonë nëpër shekuj; evidentimin dhe promovimin e ngjarjeve dhe datave historike; përkujtimin e datave të kuvendeve historike shqiptare, si Kuvendi i Lezhës, Lidhja e Prizrenit, Pavarësia e Shqipërisë, 5 maji, Konferenca e Pezës, Konferenca e Bujanit, Pavarësia e Kosovës etj.

Po ashtu, Federata do të fokusohet në përkujtimin e ditëlindjeve jubilarë të heronjve, dëshmorëve, prijësve e komandantëve legjendarë të luftërave të popullit tonë, për liri e pavarësi kombëtare si dhe në kontributin për progresin e demokracisë e konsolidimin e shtetit ligjor në dy shtetet tona: Shqipëri dhe Kosovë.

Pas miratimit të marrëveshjes për krijimin e Federatës Shqiptare të Veteranëve në kryesitë përkatëse, dy organizatat respektive u bënë ftësë publike për aderimin në të, edhe organizatave e shoqatave të tjera të veteranëve në Shqipëri, Kosovë e Maqedoninë e Veriut. Është koha që kjo ftesë e refuzuar para një viti e gjysmë (ndonëse iu dërgua dorazi nga kryetari i OBVL, kolonel Sotir Budina) të pranohet nga nga Kryesia e OVP të LANÇ “Nderi i Kombit” dhe sëbashku, në kuadrin e kësaj Federate, ku secila ruan fizionominë dhe strukturat e saj, të planifikohen e realizohen veprimtari frytdhënëse gjatë vitit në vazhdim dhe sidomos vitin e ardhshëm që është viti i jubileut të lavdishëm të 80-vjetorit të çlirimit të atdheut tonë të dashur nga okupatori nazifashist dhe i 80-vjetorit të Konferencës historike të Bujanit, programi i së cilës përcaktonte të drejtën e vetëvendosës së popullit Kosovar për bashkimin me Shqipërinë.

*Mjeshtër i Madh & Sekretar i Përgjithshëm i OBVL-së

AKTUALITET

Parandalimi i zjarreve, Peleshi takim me prefektët e kryetarët e bashkive

E hënë, 24 korrik 2023 - Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi thirri në një takim prefektët, kryetarët e bashkive si dhe drejtues të strukturave operacionale të Mbrojtjes Civile për të diskutuar në lidhje me masat për parandalimin e zjarreve gjatë sezonit të verës.

Ministri Peleshi kërkoi koordinim më të mirë të punës për përballimin e emergjencave në nivel vendor. Ai tha se Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile kanë kapacitete operacionale në dispozicion dhe janë të gatshëm të ndërhyjnë sa herë që nevojitet, por emergjencat si zjarret duhen sinjalizuar dhe ndalur që në fazën fillestare për të shmangur kalimin në përmasa më të mëdha.

“Ne nuk jemi një vend pa kapacitete operacionale. Kemi 1600 punonjës zjarrfikës në të gjithë vendin, 182 mjete zjarrfikëse, 80 autobute uji, kemi personelin dhe mjetet e FA që siç e dini që në çdo emergjencë janë në ballë të aksionit, të gjitha strukturat e policisë

që janë në dispozicion dhe me të cilët punojnë shumë mirë, urgjencën shëndetësore, rrjetin e vullnetarëve, etj.” - u shpreh z. Peleshi.

Sipas tij, që prej një viti Shqipëria ka edhe mbështetje shumë të madhe nga anëtarësimi me të drejta të plota në Mekanizmin Evropian të Mbrojtjes Civile. “Kjo do të thotë që nëse në të gjitha nivelet vendore e qendore shterojnë burimet, ne kemi edhe një suport nga ky mekanizëm që na ka funksionuar dhe është një nga më eficientët. Teknologjia është shtuar. Kemi dronët për rikonjicionet, kemi dronët Puma që janë vënë në punë nga viti i kaluar e që na japin informacion shumë të dobishëm dhe në kohë shumë të shpejtë. Gjithashtu edhe imazhet satelitore janë tani një ndihmë dhe një vlerë e shtuar.” - u shpreh Peleshi.

Sipas këtyre të dhënave satelitore, ministri Peleshi tha se janë evidentuar 125 vatra zjarrit në muajt qershor-korrik, vatra të cilat janë menaxhuar shumë mirë nga njësitë vendore. Ndërkohë ai



foli dhe për masat për situatën aktuale në dy vatrata aktive, në pyllin e fshatit Peshatn në Fier dhe fushën e mbetjeve në Vlorë. Peleshi vlerësoi punën e bërë vitet

e fundit sa i përket monitorimit, vëzhgimit dhe reagimit ndaj emergjencave, por shtoi se ka disa bashki apo rajone, kur kjo nuk funksionon.

FILOZOFIA, NJERIU BASHKËKOHOR DHE TREGU I PUNËS

Nga Ferit BAÇA

Fillimi i studimeve në fushën e filozofisë, shoqërohet me pyetjet: Përse studiohet filozofia? Ku mund të punësohesh pas diplomimit në filozofi? Disa nuk e shohin studimin e filozofisë si një profesion nëpërmjet të cilit mund të sigurosh të ardhmen përveç rasteve si mësimdhënës i saj. Filozofia është arti i mendimit dhe si e tillë lidhet e gërshetohet me çdo fushë të jetës. Bazamenti i botkuptimit filozofik përbën një pikënisje të përparuar dhe mjaft ambicioz në përvetësimin e profesioneve të ndryshme.

Çështjet filozofike që lidhen me moralin, etikën, natyrën njerëzore apo leadershipin aplikohen edhe në biznes, marketing, menaxhim, mjekësi apo drejtësi. Filozofia “injekton” një sërë dijeshe dhe aftësi të dobishme për çdo lloj profesioni. Duke menduar në mënyrë filozofike, zhvillohet më tej arsytimi induktiv dhe mendimi kritik. Filozofia mbështetet në argumente. Të gjitha shkencat e kanë origjinën te filozofia. Filozofia mbart dhe u përcjell brezave njerëzorë dijet e fituara. Si e tillë ajo është kartëvizita e individit në shoqëri. Filozofia është e vetmja disiplinë që mendon. Filozofi Gjerman Martin Hajdeger nënvizon: “Shkencat nuk mendojnë, ndaj kanë nevojë për filozofinë”.

Filozofia është rruga e vetme për njeriun të mësojë të vërtetën e ekzistencës së tij në këtë botë dhe të jetojë në përputhje me natyrën e tij. Të diplomuarit në filozofi fitojnë aftësinë e mendimit kritikë, shkruarit analitik dhe problemzgjdhës sesa të diplomuarit në degë e fusha të tjera të shkencave. Në gjenezën e saj, filozofia jo vetëm që ka lindur nga mendimi i lirë, por është e përcaktuar të mbetet si e tillë një disiplinë liberale sepse mishëron në vetevete pavarsinë e lirisë. Misioni i saj mbetet edukimi i shoqërisë me dije. Stadi zhvillimor i filozofisë është produkt i kulturës dhe dijeve të fituara. Në vijim do të veçojmë disa prej përparësive të përvetësimit të saj.

Orientimi i shpejt dhe profesional në tregun e punës: Themeluesi i kompanisë “Prospera LLC”, e cila i këshillon organizatat për çështje jo fitimprurëse dhe menaxhim të krizave, Mitchell Muncy, nënvizon: “Filozofia i përgatit njerëzit të mendojnë dhe të kuptojnë natyrën themelore dhe qëllimin



më të gjerë të punës që po bëjnë”. Sipas Muncy, nëpunësit të cilët kanë përfunduar filozofinë, aftësinë për të parë përtej mjeteve specifike, i bën ata të përshtaten më shpejt në mjedise të reja, por gjithashtu të dalin me ide e strategji të novatore, si dhe të bëjnë vëzhgime që të tjerët nuk arrijnë t'i konstatojnë. Përfundimi logjik është i qartë: Aftësitë që ata fitojnë në këtë fushë, i bëjnë më të kualifikuar jo vetëm në një drejtim, por në të gjitha fushat e jetës. Është një fakt kuptimplotë përfundimi që del nga statistikat e tregut të punës, sipas të cilave, studentët që kanë ushqyer dijet e tyre tekniko-profesionale me dije nga fusha e filozofisë, shquhen nga kolegët e tjerë për aftësitë e tyre në formulimin dhe konceptimin e rekomandimeve për stafin drejtues, për ecjen para dhe realizimin e objektivave dhe detyrave të institucionit.

Thellimi dhe përcaktimi i përparësive në procesin e punës: Njohuritë filozofike në tërësinë e tyre përfshijnë interpretimin dhe analizimin e problemeve, dukurive, ideve dhe koncepteve të mprehta me karakter teknik dhe ekonomik - financiar të

qendrave drejtuese administrative apo prodhuese.

Komunikimi bashkëkohor: Përvetësimi i njohurive filozofike i aftëson përfutuesit e tyre në përthithjen e një informacioni kompleks dhe përcjelljes së tij te të tjerët. Specialisti me njohuri të mira filozofike realizon përcjelljen tek qendrat prodhuese të udhëzimeve të stafit drejtues, si dhe përgjithëson në mënyrë efektive mendimin e përparuar shkencor. Nuk mund të ketë komunikim bashkëkohor jashtë interesave të zhvillimit të prodhimit dhe rritjes së mirëqenies së shoqërisë.

Mendimi kritik dhe zgjidhja e problemit: Filozofia konceptohet si arti i të menduarit dhe ka në qendër të vëmendjes edukimin e njeriut. Thelbi i filozofisë lidhet ngushtë me të menduarit kritik. Problemet që shtrojnë fushat e dijeshe dhe vetë jeta, kanë nevojë të shqyrtohen nga të gjitha këndvështrimet. Përvetësimi dhe ballafaqimi i informacioneve filozofike dhe teknike përcaktojnë perspektivën e zhvillimit të shoqërisë. **Formulimi dhe paraqitja e argumenteve:** Çdo problem i parashtruar ka nevojë për një konceptim të qartë teorik, për domosdoshmërinë e tij, kësisoj edhe të argumenteve përkatës, mbështetur në një logjikë të fortë bindëse dhe profesionale.

Analistë të politikave: Përgjithësisht, specialistët me njohuri të mira filozofike shquhen midis analistëve të politikave që merren me vlerësimin e ligjeve dhe programeve qeveritare ekzistuese ose atyre në prespektivë. Kjo është edhe arsyeja pse ata janë më të kërkuarit dhe më të përzgjedhurit për stafin apo bordin e punës të organizatave jofitimprurëse, mediave dhe një numër institucionesh të tjera. Në fushën e marketingut: Specialistët e filozofisë mund të kryejnë kërkime tregu dhe të hartojnë strategjitë e nevojshme për rritjen e prodhimit dhe fuqizimin e tregut. Ata mund t'i përdorin aftësitë e tyre analitike, mendimin kritik për formulimin e rekomandimeve të nevojshme dhe zbatimin efektiv të tyre. Fusha e punësimit të marketingut janë më të përshtatshme për individë me prirje krijuese në punë.

Punonjësit e medias televizive dhe shtypit: Njohuritë filozofike rrisin ndjeshëm vlerat dhe aftësitë e tyre të shkruarit dhe komunikimit me stafin

PORTRET

Modeli i një nëne të përkushtuar, që do të kujtohet gjithmonë me respekt

Bedrie Metuku, nëna heroinë, që lindi e rriti 10 fëmijë

NJË JETË PLOT SAKRIFICA POR DHE SHUMË GËZIME....

Duhet të marrim pak kohë që të flasim për jetën dhe veprimtarinë e atyre njerëzve, që me modestinë e tyre, janë shembulli më i mirë për familjen dhe shoqërinë, duke dhënë modele frymëzuese e mbreslënëse. Ata kanë lënë gjurmë të pashlyeshme te çdokush. Këta shembuj pozitiv, të shoqërojnë përgjatë gjithë trajektoreve të jetës, duke ndjerë, jo vetëm admirim, por edhe vlerësim e respekt të thellë për ta. Një ndër ata, është edhe Bedrie Metuku. Ajo njihet nga të gjithë banorët e lagjes e të fshatit, ku banonte, si modeli më shembullor dhe i kompletuar i një gruaje që mishëronte dhe rrezatonte virtyte të larta njerëzore, një qytetare e denjë, një grua fisnike, një bashkëshorte e përkushtuar, një nënë shembullore dhe e palodhur. Asgjë nuk na përgatit në jetë, për humbjen e njeriut të zemrës, siç është nëna, pasi kemi besuar, se ajo do të jetojë gjithmonë. Asgjë dhe askush nuk e merr dhe nuk e fashit kujtimin e nënës, asgjë dhe askush nuk e mbulon hijen e saj. Bedrie Metuku, është ndarë nga jeta, por ajo ka lënë pas dashurinë, dashuria le kujtimet, e kujtimet për të, nuk do të shuhen kurrë. Padyshim që është shumë e vështirë të shkruash disa rreshta përkujtimore për njeriun e zemrës, siç është nëna, ku mungesa e saj fizike është zbrazëti dhe e pazevendësueshme për fëmijët dhe të afërmit e saj. Ata gjëra, që ajo u ka mësuar dhe këshilluar fëmijëve të saj, padyshim që janë edhe trashëgimia dhe pasuria më e madhe, që ajo iu ka lënë atyre. Vlerat e një njeriu ndër më të dashurit, siç është nëna, do vërehet gjithmonë nga mungesa e saj, ndër vite. Bedria do të mbetet mes njerëzve të tyre të zemrës. Kujtimet e saj do t'i ruajnë si gjënë më të shtrenjtë dhe më të vlefshme në jetën e tyre, me dhimbje në zemër do e kujtojnë të gjithë fëmijët dhe të afërmit e saj. Ata do të jetojnë me kujtimet e tyre, që ajo u ka lënë. Ndarja nga jeta e Bedries kurrë nuk e shuan mallin dhe dashurinë që ata kanë për të. Vdekja e saj, do të mbetet plagë në zemrat e tyre. Atyre do tju mungojë buzëqeshja dhe fjalët e saj, sinqeriteti, ngrohtësia dhe urtësia e saj.

NËNË DHE BASHKËSHORTE E NJË FAMILJEJE ME HISTORI TË HERSHME, PATRIOTIKE

Në botën e saj shpirtërore si dhe të bashkëshortit të saj, Shabanit, në çdo kohë shfaqej bujaria dhe mikpritja e kësaj shtëpie. Bedria, ishte nëna dhe bashkëshortja e një familjeje me histori të hershme, patriotike e atdhetare, si dhe një ndër aktivistet e mira të grave. Bashkëshorti i saj, Shabani, ka dhënë një kontribut të veçantë kodo ku ai ka punuar, deri sa doli në pension, ku për kontributin e tij është vlerësuar me tituj e medalje. Janë disa njerëz, të cilët gjithë jetën e tyre punojnë e kontribuojnë me përkushtim, e në heshtje, ndahen nga kjo jetë, por, të përcjellë me dinjitet e të vlerësuar. Një figurë e tillë, ka qenë edhe Bedrie

• Ajo njihet nga të gjithë banorët e lagjes e të fshatit, ku banonte, si modeli më shembullor dhe i kompletuar i një gruaje që mishëronte dhe rrezatonte virtyte të larta njerëzore, një qytetare e denjë, një grua fisnike, një bashkëshorte e përkushtuar, një nënë shembullore dhe e palodhur



rie Metuku, e cila do të mbetet në kujtesën e të gjithë atyre që e kanë njohur, si model dinjitoz, prindëror e shoqëror. Ajo ka lindur në vitin 1943, në fshatin Shëlli të rrethit të Matit, por, mes lotëve, dhimbjes së madhe dhe pikëllimit të thellë, nëna Bedrie, në 3 Tetor 2022, është ndarë nga jeta, duke e përcjellë për në banesën e fundit. Ajo është martuar me Shaban Metukun, nga fshati Shqefni i rrethit të Matit, të cilët kaluan plotë 60 vite bashkë, ku pati një jetë me sakrifica por dhe gëzime. Ajo ishte jo vetëm një nënë e mirë por dhe një bashkëshorte e denjë. Bedria mungon fizikisht, për shkak të ndarjes nga jeta, por ajo nuk do të mungojë

kurrë në kujtesën e fëmijëve dhe të afërmeve të saj, të cilët do ta nderojnë dhe do ta kujtojnë për sakrificat dhe atdhetashurinë që ajo ka treguar në çdo kohë. Nënë Bedria, edhe pse nuk jeton më, ajo mbetet figura më e spikatur e familjes dhe e të afërmeve të saj. Ajo është lindur e rritur në një familje fisnike, me tradita të njohura patriotike e atdhetashurie, dhe me emër në krahinën e Matit. Bedria u formua si njeriu që respektoi veten, familjen, të afërmit dhe komunitetin. Familja Metuku, nga Shqefni i Matit, ka një histori që ka lënë gjurmë e ka përcjellë vlera njerëzore e lirisdashëse, brez pas brezi, për patriotizëm, kulturë, burrëri, trimëri, mikpritje, korrektësi dhe kontributin për paqë, mes njerëzve. Këto cilësi, ajo i trashëgoi dhe i manifestoi, jo vetëm tek vetja, por i përcolli edhe tek fëmijët dhe të afërmit e saj. Puna dhe kontributi i saj vazhdoi, duke mos u ndalur, deri sa ajo doli në pension. Simboli i ndershmërisë dhe përkushtimit, për Bedrie Metukun, kanë qenë bashkëudhëtare të jetës së saj. Ajo ka punuar në ish-Kooperativën bujqësore të shqefnit të Matit, duke përmbytur me dinjitet çdo detyrë që i është ngarkuar, Pas viteve '90-të, si shumë familje të tjera shqiptare, Bedria ka banuar familjarisht në Qytetin e Tiranës. Ajo, së bashku me bashkëshortin e saj të nderuar, Shaban Metuku, lindën dhe rritën, 10 fëmijë, nga këta: 2 djem dhe 8 vajza, të gjithë të shkolluar e të edukuar, në bazë të profileve dhe preferencave të tyre.

BEDRIE METUKU ËSHTË DEKORUAR ME URDHËRA E MEDALJE TË NDRYSHME

Për kontributin e saj, si në punë ashtu dhe në detyrat shoqërore, ajo është dekoruar me urdhëra e medalje të ndryshme, të cilat i ka lënë si "notë" vlerësimi e nderimi, dedikuar fëmijëve të saj. Kontributi i saj në punë, ishte shumë i vyer. Kudo ku ka punuar gëzonte respekt, ndjente gjithnjë dashurinë e madhe për familjen dhe të afërmit e saj. Që nga ajo kohë e deri në fund të jetës së saj, Bedria ishte një qytetare e nderuar dhe e respektuar nga të gjithë ata që e njohën. Ajo, si një nënë heroinë e vërtetë që ishte, nuk ankohej asnjëherë, ajo ishte natyrë paqësore dhe nuk donte t'u ankohej të tjerëve. Imazhin kuptimplot të njeriut të mirë, e ruajti deri në fund të jetës së saj. Moshja e saj, 79-vjeçare nuk e ndryshoi aspak arsyetimin e kthjellët. Ajo u sëmure dhe zuri shtrat, jo për t'u dergjur, por si për të bërë takimin e fundit me të gjithë ata që i donte dhe e donin. Ceremonia e varrimit e Bedries iu bë me të gjitha nderet që i takonte dhe e meritonte. Bedria nuk jeton më fizikisht, por ajo, la të gjallë punën, veprën dhe kontributin e saj, la plot kujtime të pashlyeshme, la bashkëshortin e saj, Shabanin me dy djem: Luani dhe Hasani, la dhe 8 vajzat e saj: Drita, Shpresa, Asja, Dava, Rozeta, Florida, Suela dhe Leonida, la shumë nipër e mbesa, që aq shumë i donte dhe e donin, la dhe të afërmit, që do ta kujtojnë gjithmonë me nderim e respekt të veçantë. Nëna Bedrie do të jetojë përjetësisht në kujtesën e të afërmeve të zemrës së saj. Ajo do të mbetet një Nënë e përkushtuar dhe shembullore, krenaria e fëmijëve dhe e të afërmeve të saj, duke i bërë pasardhësit e saj, të jenë krenar. Ajo ishte një nënë me vlera të pa krahasueshme, që gjithë jetën e saj, shërbeu me përkushtim e devotshmëri, e rrethuar me tituj e dekorata, por mbi të gjitha, nga respekti dhe mirënjohja e njerëzve. Bedrie Metuku është përcjellë për në banesën e fundit, në tokën, ku pemët dhe lulëkuqet, për këtë nënë të veçantë, do të jenë gjithmonë të freskëta. U prehtë në paqe dhe qoftë i përjetshëm kujtimi i NËNËS BEDRIE!

FILOZOFIA, NJERIU BASHKËKOHOR DHE TREGU I PUNËS

(Vijon nga faqja 10)

drejtues të administratës ose qendrës së prodhimit dhe komunitetit.

Konsulentë për menaxhim: Konsulentët e menaxhimit vlerësojnë, analizojnë dhe u bëjnë rekomandime kompanive për t'i ndihmuar ato t'i zgjidhin problemet brenda institucioneve të tyre. Konsulentët zakonisht punojnë për firmat e konsulencës, që kanë një numër të madh të klientëve dhe lëvizin nga një projekt në tjetrin çdo javë ose muaj.

Ajgencitë e shitjeve: Në varësi të rolit dhe organizatës për të cilën punojnë, ata mund të kërkojnë për gjetjen e klientëve të rinj të mundshëm, të identifikojnë nevojat e tyre, të negociojnë dhe të mbyllin marrëveshje midis tyre me leverdi të ndërsjelltë.

Mësimdhënës: Ata të cilët janë diplomuar në filozofi mund t'u rikthehen objekteve arsimore, por tashmë jo si studentë ose nxënës, por si profesorë. Filozofia është lëndë që mësohet edhe në shkollat e mesme.

Studimi i filozofisë si një disiplinë gjithëpërfshirëse, veç avantazheve të lartpërmenduara e pajis studiuesin me një intuitë inteligjence për thellimin e dijeve edhe në disiplinat e tjera; qofshin të fushës sociale ose të shkencave ekzakte. Është një fakt i pamohueshëm orientimi i shpejtë dhe kreativ në tregun e punës, në sektorin shtetërorë e privat, duke i ofruar stafit drejtues ide, mendime dhe projekte, i studiuesve që kanë marrë njohuri dhe dije në fushën e filozofisë, në krahsim me ata që kanë studiuar vetëm në një fushë të caktuar.

HISTORIA

Sipas studiuesit italian Gian Carlo Fusco dhe e vërteta e zhvillimeve në terren

Beteja e Dibrës, 3-11 prill 1941



NGA SAKIP CAMI

Citojmë në fillim variantin e Gian Carlo Fuscos: “Beteja e Dibrës e prillit 1941, ndonse e lënë në heshtje nga historiografia zyrtare shqiptare dhe më gjërë, u zhvillua nga 3 deri më 11 prill të vitit 1941 në luginën e Drinit, në zonën ndërmjet Zerqanit dhe qytetit të Dibrës.

Kjo luftë shkaktoi jo vetëm me qindra të vdekur nga të dy palët, italianë dhe jugosllavë, por shkaktoi dëme të shumta në njerëz e materiale ndër popullsinë shqiptare këtej e andej kufirit.

U zhvillua me urdhër të Musolinit vetëm për t’u treguar gjermanëve se sa i aftë është ai dhe ushtria e tij edhe pse ushtria gjermane po marshonte nëpër



(HARTA E MARRË NGA LIBRI ITALIAN) (GIAN CARLO FUSCO, GUERRA D’ALBANIA) FAQE 88-90, MILANO, 1977

Jugosllavi me ritme të përshpejtuara dhe pa hasur asnjë pengesë.

Me urdhër të Musolinit me 1 prill

1941, Divizioni Italian “Cuneense” që po organizohej për të sulmuar Këlcyrën, u transferua me urgjencë në Zerqan, me

objektiv zyrtar për të mbyllur luginën e ngushtë të Zerqanit në rast sulmi nga ana jugosllave drejt Tiranës. (Linja blu e hartës). Me 3 prill trupat italiane të këtij divizioni, batalionet “Pieve di Tecco” me makina dhe “Ceva” e “Mondovi” në këmbë mbërritën në Zerqan.

Me 8 prill 1941, dy ditë pasi Gjermania i kishte shpallur luftë Jugosllavisë dhe po marshonte kudo pa hasur rezistencë, trupat italiane të sapo ardhura së bashku me divizionet “Firence” dhe “Puglie” u vendosën në formacione luftimesh në formë pince (dare) nga Qafa e Prevallit e deri në Pocest.

Me 9 prill trupat italiane të ndara në dy kolona, njëra nga veriu e tjetra nga jugu marshuan drejt qytetit të Dibrës. (2 linjat e kuqe të hartës).

Kushtet klimatike shumë të këqija, reshje të shumta dëbore, acar dhe mjegull e dëndur që pengonte shikimin, vështirsonin tej mase ecjen përpara.

Ndonse trupat gjermane ndërkohë kishin marrë qytetin e Prilepit, vetëm 85 km në vijë ajrore në lindje të qytetit të Dibrës dhe po marshonin pa pengesë drejt qytetit të Dibrës nga lindja, trupat italiane për 2 ditë mbetën të bllokuara nga ushtria jugosllave dhe zjarri i artillerisë dhe nuk arritën të bënin asnjë hap përpara. Me 11 prill 1941, me kapitullimin e ushtrisë jugosllave nga ushtria gjermane dhe ndërprerja e luftimeve, ushtria italiane mundi të hynte në qytetin e Dibrës.

2 ditë luftime të kota, thjesht nën moton e Duçes “Do i thyejmë kockat armikut dhe do i tregoj Hitlerit se kush është ushtria italiane!” Ushtria Italiane e përgjysmuar dhe e demoralizuar pas 6 muaj humbesh me ushtrinë greke, i shpalli luftë Jugosllavisë, duke sulmuar në Dibrë dhe në Koplik. Në Koplik u thye dhe trupat jugosllave arritën deri në Vrakë dhe rrezikuan Shkodrën, kurse në Dibrë nuk bënë asnjë hap përpara, por rrezikuan thyrjen dhe lënien e lirë të rrugës për Tiranë.

Përparimi në mënyrë të përshpejtuar i ushtrisë gjermane nga Prilepi në Dibrë të madhe, solli kapitullimin e trupave jugosllave dhe shpëtoi italianët nga thyerja e plotë. Sikurse duket nga harta, vijat e kuqe, divizioni pasi përqëndrohet në Zerqan, marshon në dy krahë, të majtë dhe të djathtë që synojnë Dibrën e madhe. Brenda kësaj dare janë fshatrat Strikçan, Lubalesh, Viçisht, Pasinkë, Çerenec, Shupenzë, Topojan, Bllatë e epërme, Maqellarë.

Aksioni luftarak i prillit 1941, kundërveprimi ndaj fashistëve, dëshmorët e parë

(Nga libri im “Lufta Nacional Clirimtare në Dibër, faqe 155-156)

Në ditët e para të prillit, italianët shtrinë forcat e Divizionit “Firence” në vijën Maqellarë-Shupenzë-Miresh-Klenjë e deri në Librazhd. Në brezin e dytë që fillonte nga Smolliku në Strikçan-Zerqan-Fushë-Bullqizë-Mali i Bllacës-Katër Grykët që vendosur Divizioni Alpin “Brenero”. Atdhetarët dibranë bënë planin për t’u nisur në dy drejtime: Haxhi Lleshi, Ahmet Cami dhe Ymer Lleshi me 200 veta u nisën në krahun Sebetovë, Tërbaç, Çerenec, Viçisht. Aqif Lleshi me Hamdi Lleshin me 100 pushkatarë në Bllatë, Reshan e Maqellarë.

Siç shkruhet në krye të hartës, atdhe-


tarët dibranë me insistimin e tyre luftuan kundër trupave fashiste në vijën Miresh, Sepetovë, Vicsisht, Cerenec, Bllatë, Kllopcisht.

Më 6 prill filluan veprimet luftarake dhe në befasi të plotë u morën postat kufitare të Ostrenit, Mireshit e Viçishtit dhe erdhën deri në kodrat e Gjoricës. Forcat e komanduara nga Aqif Lleshi morën postën e Bllatës. Gjatë luftës u bashkuan shumë fshatarë me luftëtarët kundër pushtuesve. Armiku la shumë të vrarë e të plagosur, sidomos në Miresh ku u godit një batalion i Divizionit Firence dhe u vranë 50 oficerë dhe ushtarë italianë,

u zunë shumë armë, municione, veshmbathje, e ushqime që ju shpërndanë luftëtarëve.

Ranë dëshmorët e parë Abdurahim Lleshi e Vebi Jashari në Zonën e Maqellarës. Në kodrat e Çerenecit u vra mësuesi patriot Fasli Cami duke kryer detyrën e korierit. Më vonë italianët vranë Musa Camin, Ejup Camin e Mexhit Lezin. Mbetën të plagosur Sefer Prapaniku nga Prapaniku dhe Xhelo e Hysen Jashari nga Kovashica. (LANÇ në Dibër Faqe 388). Pas kapitullimit të Jugosllavisë, Italia fashiste dërgoi forca të mëdha në Dibër të Madhe. Ku filluan raprezaljet, internimet e masat e tjera shtypëse kundër luftëtarëve që përgjakën ushtritë pushtuese më 6 prill. Në këto kushte u bë e vështirë lëvizja prej 300 e ca vetësh, prandaj ato u shpërndanë pranë familjëve me qëllim që të vazhdonin veprimtarinë antifashiste në forma të ndryshme. , të gatshëm në kohën e riorganizimit, të kujdesshëm edhe ndaj mashtrimeve. Në pabesi” burgosën Ahmet Camin, disa Came të tjerë, Murat Bashën, Sali Llanin, Jashar Lelën, etj. Pëllumb Lleshin, Lutfi Lleshin, Shaqir Skukën, Nuz Majtarën i zbuluan dhe i internuan në Peqin, Kavajë e gjer në Itali”. (Haxhi Lleshi ,Vite, Njerëz, Ngjarje, Tiranë, 1996 fq 43).

Autori italian e quan këtë luftë një luftë të kotë, një kapricio të Musolinit, por lufta e beteja të kota nuk ka sepse vriten njerëz e ushtarë nga të dyja palët. Dibranët i mbrojtën me gjak trojet e tyre, ndonëse të pakët në numër e me armatim të pakët.



(HARTA ËSHTË MARRË NË MUZEUN HISTORIK TË DIBRËS)

HOMAZH

Për intelektualin që i përballoi me dinjitet sfidat e jetës, ish anëtar i Këshillit Drejtues Kombëtar të OBVL

LAMTUMIRË HALIT BERISHA

Me 27 Qershor 2023, vetëm pesë ditë pasi kishte përcellur bashkshorten e tij Naxhien për në banesën e fundit, familja, shokët dhe miqtë e shumtë i dhanë lamtumirën HALIT BERISHËS, një nga përfaqësuesit dinjitozë të elitës dibrane.

Bashkohësit do ta kujtojnë Halitin si simbol të mirësisë, urtësisë e mençurisë dibrane.

I lindur më 13 prill 1941, Haliti kaloi një fëmijëri të vështirë. Ndonëse u rrit jetim për babë, që në fëmijërinë e tij të hershme, do të trashëgonte virtytet më të mira të të parëve të tij, të familjes e fisit emërndritur Berisha të Muhurrit. Mes vështirësive të panumërta, i detyruar t'i vijë në ndihmë familjes që në moshë foshnjore, krahas vijimit me zell të mësimave në shkollën 7-vjeçare, do të përballonte punë nga më të rëndomtat në bujqësi e blegtori.

Ishin vitet "60-të të shekullit të kaluar, kur në kontekstin e zhvillimeve shoqërore të asaj kohe, rinia ishte promotore e ndryshimeve të vrullshme. Ajo kohë kishte kënaqësitë e veta, por edhe vështirësi e sakrificat të mëdha.

Pikërisht në kontekstin e këtyre zhvillimeve formësohet edhe profili i Halit Berishës, djaloshtit simpatik sykaltër që do të spikaste mes ekipit të ish-Komiteteve të Rinisë e Bashkimeve Profesionale të rrethit Dibër për vizionin e tij bashkëkohor.

Halit Berisha, ishte ndër më të mirët, falë aftësive e talentit, por edhe bukurisë së tij të rrallë fizike e shpirtërore.

Megjithëse jetim, me vëllain e vetëm më të vogël Likën e nënë Hanen, zemërmirë e fisnike, që rropatej për t'ua plotësuar sadopak kushtet e jetesës, kur sapo kishte dalë në jetën e tij aktive, Haliti do t'i duhej të kryente shërbimin e detyruar ushtarak, jo në ndonjë repart të afërt në vendlindje, por siç veprimeve të rëndomta asokohe me të rinjtë pa përkrahje, e degdisin 400 kilometra larg shtëpisë, në Repartin 401 të kufirit në Sarandë. Por kufitarit dibran, që mbartte me vete një përvojë të pasur jetësore të fituar në vendlindje, do t'i vinte në ndihmë pikërisht kjo përvojë për të evidentuar aftësitë dhe inteligjencën e tij natyrore dhe atë të fituar në shkollë e në aktivitetet me rininë. Si të tillë, por edhe si djalë energjik e me karakter të fortë e caktojnë në sekretarinë sekrete të repartit. Imagjinoheni, një djali të rritur me vështirësi të shumta, por të formuar e kalitur përmes tyre i duhej të përshtatej me kushte e rrethana krejt të reja, ku i besoheshin planet sekrete tekniko-operative të përballimit të ndonjë agresioni të mundshëm grek, si ai i provokacioneve të gushtit '49. Por pikërisht shërbimi me devotshmëri e përkushtim në atë repart ushtarak, i shërbeu atij për të krijuar lidhje të reja miqësore dhe mbi të gjitha për t'u formuar si kuadër. Në këtë repart të largët, Halit Berisha do të përsoste talentin e tij edhe në një aspekt tjetër. Si askush tjetër, këtu do të perfeksiononte profesionin e daktilografistit, pikërisht në kohën kur makina e shkrimit ishte ndër mjetet më të perfeksionuara të asaj kohe, në raport me "artilërinë" e mjeteve të sotme shumë të sofistikuara,



në funksion të komunikimit në botën dixhitale, që asokohe as që mund të imagjinohej. Por Haliti, që as nuk i shikoheshin gishtat, për vetë shpejtësinë me të cilën përdorte makinën e shkrimit, do të ishte i preferuar nga nomenklatura e kohës. Madje, kjo do të ishte dhe një arsye e këmbënguljes së komandës për ta mbajtur në punë si shef të sekretarisë sekrete të repartit edhe pas mbarimit të kohës së shërbimit të detyruar ushtarak. Por Halit Berisha, kurrësi nuk mund të braktiste nënën dhe vëllain e vetëm që i kishte qindra kilometra larg repartit, ndaj dhe më 7 dhjetor 1962 u kthye përgjithmonë në vatrën e tij të ngrohtë familjare, tashmë si një kuadër i përgatitur për të marrë përgjegjësi e sfida të reja.

Nuk kishte kaluar as një muaj nga koha e mbarimit të shërbimit të detyruar ushtarak, kur Halit Berishën, në fillimin e janarit 1963 e emërojnë instruktor në ish - Komitetin e Rinisë të rrethit Dibër. Punoi plot katër vjet në këtë funksion, ku zhvilloi talentin e tij dhe u miqësua me njerëz të moshave e profesioneve të ndryshme nga i gjithë rrethi, gjer në Lurë, Kala të Dodës, Steblevë e Bulqizë. Plot katër vjet, sa koha që kalon një student në auditoret e një universiteti, i dhanë atij "diplomën" e "studentit" të odës dibrane e të kuvendeve të Dibrës, të konsideruar si universiteti më i mirë i kohës. Kalon moshën e rinisë dhe sërish Halit Berishën e mbajnë në një tjetër strukturë të organizatave shoqërore të asaj kohe, siç ishin Bashkimet Profesionale të Rrethit. Punoi plot dhjetë vite si llogaritar i Bashkimeve Profesionale të rrethit Dibër, kohë kur ai mbahet mend e vlerësohet nga shokët e miqtë e tij të shumtë, si Sinan Saraçi, Agim Kaba, Baftjar Shahini, Ismete Jashari etj, si një nga kuadrot e përgatitur, korrekt e mjaft i devotshëm në përkushtimin e tij qytetar. Megjithë vështirësitë e kohës, (pasi për 15 vite si instruktor rinie dhe në Bashkimet Profesionale i duhej të udhëtonte për çdo ditë nga katër orë më këmbë Muhurr-Peshkopi dhe anasjelltas), ai kurrë nuk u gjunjëzua, përkundrazi ngjiti me meritë shkallët e karri-

erës. Një tjetër funksion i përgjegjshëm që ka kryer Halit Berisha për 11 vitet në vijim (1975-1986) ka qenë ai i Kryetarit të Degës së Planit në Minierën e Mermerit Muhurr. Ishte një dekadë përballjeje deri në Komisionin e Planit të Shtetit e në instanca të larta të Ministrisë së Industrisë e të rrethit Dibër, që



pretendonin e kërkonin të realizoheshin plane të fryra në një minierë ku kushtet e punës ishin tejet të rënda. Por për çdo vit, planet e kësaj miniere që mbanin firmën e Halit Berishës qenë reale dhe konkurrese me të gjitha ndërmarjet simotra. Këtë e dëshmojnë më së miri në vlerësimet e tyre për Halitin, ish-drejtorët në vite të kësaj miniere, Besim Sadiku, Rustan Loka e Hekuran Domi, duke përveçuar edhe humorin e këndshëm e mendjemprehtësinë e tij për të kapërcyer edhe situata të ndërlikuara. Me të njëjtën përgjegjësi e përkushtim punoi ky kuadër me përgatitje profesionale e moral të lartë edhe në Degën e Tregtisë Muhurr (1986-1992) dhe në ndërmarjet tregtare e atë të grumbullimit Bulqizë (1993-1995), duke përballuar vështirësitë ekstreme të asaj periudhe, kur mungonin gjërat më elementare, deri edhe ushqime të paketës bazë. Por edhe në këto rrethana ai diti të përshtatet dhe të krijojë figurën e intelektualit të respektuar nga kolektivi

dhe komuniteti ku shërbeu.

Që në Kuvendin e 6-të të OBVL (Maj 2017) është zgjedhur anëtar i Këshillit Drejtues Kombëtar të kësaj organizate dhe për disa vite ka qëndruar pranë kryetarit të kësaj organizate, gjeneral Rrahman Parllaku – Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit. Si pasardhës veterani (kushëriri i tij i parë Osman Berisha ka qenë pjesëmarrës aktiv me armë në dorë në Brigadën e 18 S) Halili ishte mbrojtës dhe propogandues i flaktë i vlerave të LANÇ.

Halit Berisha ishte dhe do të mbetet në memorien e të gjithë atyre që e njohën, si model i përkushtimit qytetar, shtetëror dhe shoqëror në të mirën e gjithsecilit. I pakursyer në dhënien e ndihmës dhe eksperiencave për të rinjtë dhe nevojtarët. Model i një bashkshorti, familjari, prindi dhe bashkqytetari dinjitoz dhe miqësor.

Tashmë që prej 25 vitesh, Halit Berisha jetoi familjarisht në Tiranë, në gjirin e familjes së tij të mrekullueshme, me bashkëshorten Naxhien, djalin Bujarin, nusen e djalit Fiqirien (Kollaku), mbesën Amarilda e nipin Serxho, ndërkohë që përkujdesje maksimale ndaj tij tregojnë katër vajzat, Kimetja që e kishte fare pranë shtëpisë së tij si dhe Kujtimja, Natasha e Lumja që prej shumë vitesh jetojnë e punojnë familjarisht

në Bruksel. Ai i gëzohej gjithashtu progresit dhe dashurisë së nipërve Bledar e Arlind Rama, Oligert e Kallashnikov Hoxha dhe Paris Jovani, fëmijëve të tyre, Keidës, Alesias, Eltonit e Fitimit, të cilët me sjelljen e përkujdesjen ndaj tij i dhuruan lumturi të veçantë, tashmë në moshën e tretë.

Ata, si dhe të gjithë ne, tekta e përcollën për në botën e përtejme, të përloitur e me dhimbje të thellë i thanë:

Të goftë i lehtë dheu i tokës mëmë. Parajsa goftë vendbanimi yt i përjetëshëm!

**Shuaip METHASANI
Kamber FARUKU
Muharrem GJOKA
SANIE BATKU
Demir RUSI
Sakip CAMI
NAIM BERISHA
Halil RAMA**

SUPLEMENTI "LETRAT"

"PILOTI DHE NJERIU" – pjesë nga libri "SHQIPONJA E DUKAGJINIT"

Për aviatoret, Etem Memeti dhe Ndue Logu

Nga Gjin Musa

Bie telefoni në repart. Ndue Logu ndodhej në zyrën e tij. Ushitari i shërbimit e njofton se telefonojnë nga Ministria e Shëndetësisë. Zëvendës-komandanti Ndue e merr shpejt telefonin dhe e kupton se një nevojë urgjente shtrrohej përpara. E në fakt ashtu ishte. Bëhej fjalë për një udhëtim urgjent në Malësi, më saktë pikërisht në zonën e tij, në Dukagjin. Në fshatin Toplanë, një nënë e re nuk arrinte të sillte në dritë foshnjën e saj, me gjithë ndihmën që po i jepte personeli shëndetësor i zonës. Pa e zgatur, u përgatit me shpejtësi, mori me vete ndihmësin dhe një teknik e tek materniteti i Tiranës morën edhe një mjek gjinekolog. Nisi fluturimin drejt malsisë. Ishte rrugë që e njihte edhe me sy mbyllur, sepse e çonte në vendlindjen e tij. Pastaj, pikërisht në atë fshat kishte qenë edhe njëherë tjetër në vitin 1968, në periudhën e elektrifikimit të vendit. Kishte transportuar transformatorin elektrik, që do të jepte dritë fshatit.

Ndueja e ngiste helikopterin i përqëndruar e mendohej të fitonte sa më shumë kohë. Dy jetë njerëzish ishin në rrezik: një nënë e re dhe foshnja e saj. Kur kaloi mbi kantierin e madh të Hidrocentralit të Komanit në ndërtim e sipër, e kuptoi që po i afrohej fshatit. E drejtoi me kujdes avionin, pikërisht tek pika ku dikur kishte shkarkuar transformatorin. Ndërsa po bënte manovrat e uljes pa që një grup njerëzish me një barelë po i afrohejshin vendit ku do ulej avionin. Ndueja do të donte të ulej e t'i përqafoje një nga një ata malësorë, por koha nuk prite. Nuk e fiku motorin e elika vazhdohej të vërtitej me zhurmë e me atë vrundullin e erës që ajo krijon. E futën me shpejtësi në bord barelën me nusen e re që ishte e zbehtë në fytyrë. Pranë saj një djalë i ri malësor, i shoqi, dhe një grua në moshë mesatare, me siguri vjehrra.

Mjeku u afrua menjëherë pranë lehonës për të kuptuar situatën. – Nuk duhet të humbim kohë, – i tha ai pilotit. Ndueja e ngriti me shpejtësi helikopterin dhe mori rrugën e kthimit për në Tiranë. Në një moment i hodhi sytë tek barela. Nëna e re i hapi për një çast sytë dhe nga zhurma e kuptoi që ishte në avion. Ajo nuk kishte hipur kurrë në avion. Madje avionin e parë e kishte parë atje në një brinjë të fshatit, ishte relikeja e një avioni gjerman të rrëzuar në kohën e luftës... Mjeku merrej tërë kohën me nënën e re. Kurse malësori i ri pranë saj, rrinte i heshtur, vështronte diku larg e nuk linte të kuptohej asnjë emocion, siç është në natyrën e malsorëve. Të njëjtën pamje prej skulpture të heshtur kishte edhe vjehrra. Arriti në Tiranë, i la ata tek materniteti pranë stacionit të trenit dhe u kthye në repart. Vazhdohej të kryente detyrat e tij të përditshme si zëvendëskomandant, por mendjen e kishte atje, tek ajo nënë e re dhe tek foshnja.

Doli nga repart kur kishte filluar të binte mbrëmja. Vajti në shtëpi, u ndërrua dhe tek po dilte, i tha Verës, bashkëshortes:- Po shkoj deri tek materniteti. Na përgatit ndonjë gjë të mirë për darkë.

Tek materniteti u ndal përpara infermieres së shërbimit. – Desha të pyes për atë malsoren nga Dukagjini. E solla sot në dreq me helikopter, – tha ai. Infermiera i buzëqeshi me dashamirësi dhe i tha:- Ishte një lindje e komplikuar, por ekipi i mjekëve arriti të shpëtonte edhe nënën, edhe fëmijën. Janë mirë që të dy. Ndueja u gëzua, u çel në fytyrë dhe e falënderoi infermierën.

– Po i shoqi i saj me të vjehrrën, ku janë?- pyeti ai pas pak.

– Ata tani sapo dolën, dëgjova që do shkonin të zinin vend në hotel. Janë të afërm tuaj?- i tha ajo.

– Janë njerëz të zonës sime, – iu përgjigj dhe mori rrugën për nga dera. Nxitonte hapat nëpër bulevardin e gjatë drejt qendrës. Diku përpara dalloj veshjen e gruas malsore. I pa tek po hynin tek hoteli i parë në të djathtë të rrugës. I arriti në holl dhe i përshëndeti. Ata e panë si me habi.

– Jam ai piloti që u solla sot me avion. Edhe unë jam dukagjinasi, jam nga Shoshi.

– A, ti je Ndue Logu? Kemi dëgjuar të flitet për ty, – tha burri dhe i shtrëngoi dorën.

– U gëzova që lindja shkoi mirë. Urime e jetë të gjatë fëmijës, – tha Ndueja...-Po sonte nuk do zini vend në hotel. Do vini në shtëpi nga unë. Do festojmë së bashku me familjen time.

Dolën sëbashku e u përzien mes njerëzve në bulevardin e madh. Tek ecnin rrugës drejt shtëpisë e bisedonin për ngjarjen e ditës, Ndues i erdhi ndërmend një rast tjetër lindjeje të vështirë. Atëherë kishte qenë në Iballë të Pukës. Ishte qershori i vitit 1970. Helikopteri me ekipin e mjekëve u nis me shpejtësi nga Tirana. Koha ishte e bukur, ditë vere. Por kur hynë mes maleve të Pukës, koha u keqësua papritur. Filloi një nga ato rrebeshet e papritura, mjegulla u dendësua dhe nuk shikoheshin më as grykat e qafat e maleve. Vazhdimi i udhëtimit për më tej u bë thuajse i pamundur dhe



me një rrezikshmëri të madhe për pilotin dhe ekipin e mjekëve. Dispeçeri, që nga Tirana, i tha që mund të ktheheshin pa rrezikuar më shumë. Në sytë e mjekëve filloi të dukej një shprehje alarmi, sidoqë mundoheshin të mos e shprehnin frikën.

– Si mund të kthehem prapa? Po ajo nënë që është gati në thonjtë e vdekjes bashkë me fëmijën?- pyeti ai.

– Në këto kushte atmosferike unë nuk mund t'ju autorizoj të vazhdoni më tej udhëtimit. Ju këshilloj kthimin në bazë, -tha dispeçeri.

– Unë arrij ta gjej rrugën edhe në kushte të vështira. Ma lini mua përgjegjësinë për vazhdimin e misionit, -i tha Ndueja. –Mos u shqetësoni, -u tha mjekëve. – Do arrijmë shëndoshë e mirë e do ta kryejmë këtë mision të përbashkët... Siguria e tij dhe qetësia me të cilën fliste ua ktheu buzëqeshjen mjekëve. Ndueja manovronte i qetë, sytë e tij prej shqiponje dukej sikur e shqyenin mjegullën e dendur.

Nëpërmjet shlimofonit filloi të komunikonte me ata të zonës ku do arrinte. Si të ishte duke fluturuar drejt shtëpisë së tij, ai e gjeti rrugën dhe e drejtoi helikopterin drejt një are me misër, e vetmja parcelë e sheshtë në afërsi të kullës malësore. Malsorët vrapuan drejt helikopterin dhe sollën edhe lehonën në barelë. Një nënë e moshuar ju afrua pilotit, e përqafoi dhe i tha: Përpara këtij kujdesi, edhe po të vdesë vajza ime, do me duket sikur e kam perherë të gjallë, – i tha.

– Rri pa merak, nënë, me vete kam mjekë të mirë. Tani vajza jote është në duart e jetës e jo të vdekjes, -i tha ai dhe e nisi avionin. Mjekët u vunë në punë përnjëherësh. Njerëzit e afërm të nuses ndiqnin me ankth situatën. Jashtë furtuna tërbohej gjithnjë e më keq, por Ndueja manovronte me guxim e kthjelltësi lëvizjesh. Pas ca u dëgjua një e qarë fëmije. Mjekët arritën ta realizonin lindjen e vështirë që në ajër. Kishte lindur djalë. Në avion u krijua një atmosferë e gëzueshme e nuk donin t'ja dinin për atmosferën e egër që ishte tej xhamave. Lanë prapa malet e Pukës e prapë dielli i qershorit lëshoi rrezet mbi avion.

– Duam të të bëjmë kumbar. Dëshirojmë të na e zgjedhësh emrin e djalit, -i thanë Ndues të afërmit e nuses.

– Shumë e kollajtë. Lindi në ajër e do ta quajmë Ajrin. Ju pëlqen ky emër?-tha Ndueja.

– Ta gëzojmë! -qe përgjigja si në kor e të gjithëve sa ishin në avion.

Aftësitë e tij si pilot i vlerësonin shumë edhe banorët e zonave të thella malore ku ai ishte ndër të parët që nisej me shërbim. Njëherë vajti me grupin e shërbimit në Progonat. Vendi ku do të ulej avioni ishte tepër i ngushtë për shkak të terrenit të thyer. Ai e vërtiti helikopterin nja dy herë sa për të fiksuar mirë në kujtesë se ku do ta ulte. Shokët në bord u panë sy ndër sy, si për të thënë: -Po ky e ka me gjithë mend që kërkon ta ulë avionin në atë rrëpirë? Ndueja bënte manovrat e tij dhe e uli helikopterin me një precizion të rrallë, sa dukej sikur e saldoi mbi shkëmb. Banorët e fshatit u afruan dhe një plak i moshuar, duke i rrahur supet

pilotit, i tha:- Në këtë shoshë vend, edhe shqiponja po të ulej, rrezik do e kishte thyer ndonjë krah. Kurse ti ule avionin aty pa asnjë problem.

Një herë tjetër, një grup alpinistësh ishin bllokuar nga një tufan i egër në një lartësi të thepisur të Vuklit në Kelmend. Malësorët e zonës, të alarmuar ishin nisur t'u shkonin në ndihmë. Por tufani i tërbuar i pengonte të ngjiteshin. Ndërkohë Ndueja me helikopterin e tij e me një ekip shokësh ishin nisur që nga Tirana për të mos lejuar që stuhia e egërsuar të merrte jetë njerëzish. I mësuar me fluturimet edhe në kushte të vështira atmosferike dhe duke qenë një njohës i mirë i terrenit në gjithë territorin e Atdheut, Ndueja ja doli të orientohej pa humbur kohë e të arrinte në vendin ku ishin bllokuar alpinistët. I mori në helikopter dhe i zbriti atje ku prisnin malsorët e tjerë të shqetësuar. Sa zbritën alpinistët në tokë, një malsor iu drejtua atyre: – Cili prej jush e ka vëllanë aviator, që e solli avionin aq shpejt nga Tirana?

Ndueja i dëgjoi këto fjalë dhe ju përgjigj malsorit: – Unë jam bir i këtyre maleve, si ju, dhe të gjithë jemi vëllezër.

Udhëtimet e shërbimit me avion në zonën e tij i priste gjithmonë me një emocion të veçantë. Atje takonte banorë të zonës së Dukagjinit, që e kishin për krenari kur e takonin djalit e tyre, se të gjithë e konsideronin si djalë të shtëpisë. Një herë e dërguan në Koman, ku po ndërtohej hidrocentrali i madh. Një punëtor ishte në rrezik jete. Ndueja u nis me një ekip prej katër mjekësh dhe e uli avionin në territorin e kantierit. Mjekët shkuan t'i jepnin menjëherë ndihmë e parë punëtorit përpara se ta vinin në avion. Kursi piloti Ndue zbriti e po rrinte pranë helikopterin. Menjëherë e rrethuan shumë punëtorë, që ishin nga krahina të ndryshme të Shqipërisë. Nga mesi i tyre doli një malësor, e përqafoi me mall Nduen, pastaj ktheu kokën menjëherë e u largua pak. Një lot i rrëshqiti nga syri e malsorët nuk duan t'jua shohë kush lotin. Por Ndueja e thirri:-Axxhë, po prit o burrë, mos e fshih lotin, se lot gëzimi është. Pastaj ai u tregoi të tjerëve se atë malsorin e kishte thirrur përherë axhë edhe pse nuk e kishte të tillë, por që në fëmijëri kishte ndërtuar këtë raport respekti me të.

Kur ishin dimra të egër, zakonisht zona e Dukagjinit, por edhe zona të tjera malore bllokoheshin nga bora e thuajse izoloheshin nga pjesa tjetër e vendit. Atëherë repartit i helikopterëve kishte shumë punë. Avionët ngarkoheshin me ndihma ushqimore të akorduara nga qeveria dhe u dërgoheshin banorëve të fshatrave në vështirësi. Në një dimër të tillë ishte bllokuar fshati Mollë i Shoshit, pikërisht zona ku Ndueja kishte lindur. U caktua një ekip i kryesuar nga Sinan Çela. Ndueja kishte pak kohë që nuk fluturonte më, por kryente një detyrë tjetër në repart. I thanë që të shkonte edhe ai me ekipin, meqë ishte nga ajo zonë dhe i njihte mirë rrugët. Ai e dinte që Sinani ishte pilot i zoti dhe nuk kishte nevojë për ndihmë, por udhëtimit me ekipin e pranoi me dëshirë. Kur po depërtonin për në zemër të maleve, pilotët e tjerë të ekipit filluan të shikonin hartat. Ndueja vështronte i qetë nga dritarja, po shfaqeshin ato maja e lugina që ndërthureshin në një terren të ashpër e epik e që ai i njihte mirë. Ndjente krenari e mall për to. Poshtë lumi i Lesniqes thuajse ishte zhdukur nga ngricat e nga dëborat që vazhdohej të binte. Rrugëkalimet e fshatit dukeshin si vija të holla të hequra mbi dëborë. Fshati mollë ka pak shtëpi e në distancë nga njëra-tjetra. Por të tëra, edhe në atë dimër të egër, ishin të lidhura me njëra tjetrën me ato vija të holla. Malsorët, veçanërisht në momente vështirësish, bashkohen e lidhen edhe me shumë me njëri-tjetrin. E djali i tyre, bashkë me shokët, po shkonte t'u çonte ndihmën që nga Tirana

Vetitë njerëzore të Ndues shfaqeshin edhe në momentet më të zakonshme. Ai dinte të ishte i sjellshëm e korrekt me kolegët e me ushtarët, t'u vinte në ndihmë kur kishin nevojë, ishte i rreptë në qortimet e tij, e nganjeherë kur e tepronte dinte të kërkonte edhe falje. Disa ushtarë kishin gabuar gjatë shërbimit dhe Ndueja u nervozua shumë e i qortoi me një ton të pazakontë, që edhe shokët nuk ja njihnin. Iku i zemëruar në shtëpi atë mbrëmje. Të nesërmen, kur erdhi në repart, i thirri ata ushtarët dhe përpara të gjithëve u tha: – Ju gabuat rëndë dje, por edhe unë e djallosa.

Aliu, njëri nga kolegët kishte radhën e shërbimit në repart. Por i doli një hall familjar dhe vajti të fliste me Nduen si zëvendëskomandant që ishte. Ndueja e dëgjoi dhe i tha: – Mos e ki problem. E kuptoj hallin tënd. Do të të zëvendësoj unë, por po munde shko e ma njofto Verën që nuk do kthehem sot se jam me shërbim. Vetëm më vonë, nga shokët e vet Aliu mësoi se Ndueja atë ditë kishte programuar të shkonte me të shoqen, Verën, në Shkodër, madje kishte biletat e udhëtimit në xhëp. Dhe për të ndihmuar shokun hoqi dorë nga udhëtimi.

LIBRI

Rreth librit "Shqiptarët dhe ndërkombëtarët" ku ndër të tjera autori shpreh mirënjohjen ndaj demokracisë amerikane

SHPENDI TOPOLLAJ, SHEMBULL I ÇMUAR NË MBROJTJE TË ÇËSHTJES KOMBËTARE

DR. SHK. NOVRUZ ZEJNATI

Ndofta kritiku i mirënjohur Fatmir Minguli e ka përcaktuar më qartë me dy fjalë figurën e Shpendi Topollajt, duke e quajtur atë në librin që i ka kushtuar "Një shkrimtar i çuditshëm". Autorë të tjerë para meje janë përpjekur ta sqarojnë në pesë libra domethënien e këtyre fjalëve, duke u mbështetur në vlerat e tij njerëzore, jetën interesante të tij, nisjen e botimit të librave pas ardhjes së demokracisë dhe që janë plot 73 të tilla, faktin se ai duke qenë oficer (nuk mund të mos e theksoj: nga më të zotët), dhe jurist, nuk ka studiuar posaçërisht për letërsi, lëvrimin e ç' do lloj zhanri letrar, talentin e spikatur, kulturën e pakrahasueshme, ndershmërinë, ndihmën e pakursyer për këdo, duke organizuar veprimtari promovuese pafund dhe asnjë herë për vete, redaktimin e korrektimin e librave të tyre, parathëniet dhe analizat kritike për ta që kapin deri tani shifrën e 35 volumeve, mbajtjen e fjalës për secilin, kudo që organizohet, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë e Maqedoni të Veriut, botimin e tyre nëpër gazetat e portale, praninë e tij gati të përditshme në shtypin e shkruar, shkuarjen në takime me nxënësit e mësuesit, intervistat e shumta në radio e televizione, pjesëmarrjen nëpër juritë e konkurseve të ndryshme, përkthimin e veprës së tij në disa gjuhë të huaja, drejtimin e disa organizatave dhe shoqatave jo fitimprurëse, dhurimin e librave prej tij, akordimin e disa çmimeve e vlerësimeve që i janë bërë, e deri mbajtjen e fjalës së përcjelljes të shokëve që ndërrojnë jetë, miqve të tij të shumtë, mungesën e kushteve normale për krijimtarinë e një shkrimtari, pasi jeton në një sipërfaqe prej 50 m², ku nuk ka vend as për librat, etj. etj. Por unë do të theksoja edhe diçka tjetër: preokupimin e tij për çështjen kombëtare, qartësinë me të cilën e arsyeton atë dhe kurajën e rrallë për t'i shprehur hapur mendimet dhe opinionet e veta, çka del më së miri edhe në librin e porsabotuar nga SHB 2M Printing, me titullin "Shqiptarët dhe ndërkombëtarët". Karl Popperi një herë pati thënë se "Kush kërkon të vërtetën duhet të guxojë për të qenë një revolucionar në fushën e mendimit". Dhe ja sesi shprehen për të akademik Kopi Kyçyku dhe shkrimtari Nazmi Seitaj fjala vjen. I pari, duke u mbështetur në një analizë të tij thotë: "Jehonat e kësaj klithme dhembjeprurëse kanë shpuar tashmë qiejt me shpatën e mprehtë të atmëmëdhedashurisë".

Kurse i dyti "...mendimtari i shquar Shpendi Topollaj është në lartësi Himalaje të artikujve tanë kritikë dhe që mbetet i paarrtshëm... Sikur të isha President i këtij vendi do ta kisha dekoruar me çmimin më të lartë". Çmimin e lartë "Pushkin" ja akordoi atij 7 - 8 vjet më parë edhe LSHA të Rusisë, por ai nuk hezitoi ta kthejë mbrapsht kur pa se ai vend dërgoi ushtrinë me tanke, topa e avionë kundër popullit paqësor të Ukrainës, duke dhënë kështu një shembull shumë domethënës. Po ashtu, Shpendi nuk e fsheh revoltën e tij kur sheh qëndrimin nënshtrues të politikanëve tanë ndaj të huajve. Artikujt e tij plot llogjikë dhe patos, para se të përfshiheshin në këtë libër, janë bërë publike duke u botuar nëpër gazetat e përditshme. Qëllimi i tyre ka qenë që të tërheqin vëmendjen e një mase sa më të gjerë lexuesish. Ato fare mirë mund të quhen apollojji për Kombin tonë të coptuar, ngritje zëri për korrigjimin e gabimeve mbi një shekullor që janë bërë ndaj nesh, duke e parë ndreqjen e tyre vetëm të bashkimi i trojeve tona. Në shkrimin e tij "Politikanë flisni burrërisht për problemin kombëtar të bashkimit..." ai u drejtohet hapur atyre që na drejtojnë: "...nëqoftë se keni ndërmend të bëni ndryshime në Kushtetutë, së pari ndreqni nenin e Parë kështu: "Synimi parësor për ne është bashkimi i trojeve shqiptare kudo që ato janë". Dhe vazhdon duke u kujtuar atyre se: "Jeni pasardhës të heronjve të Lidhjes së Prizrenit, atyre burrave që nuk e njihnin frikën, prandaj t'u ngjisni atyre në dashurinë dhe sakrificat për At-dhe. Vetëm kështu do të mbetenit të nderuar në jetë të jetëve si ata". Dhe për këtë mendim të tijin, ai e përgatit lexuesin qysh në krye kur evokon fjalët e famshme të Euripidit, filozofit shumëplanësh i cili thosh: "O, kurrë mos u lodh për ndihmën që i jep Atdheut". Dhe është kjo arsyeja që ai këto fjalë ua drejton si thirrje së pari, intelektualëve të andej e këndej kufirit. U thotë atyre se duhet marrë shembull nga burra si diplomati



• **Atij i dhimbset fati i Kombit tonë të shumëvuajtur, dhe bashkimin e tij e sheh së pari te përpjekjet e vetë shqiptarëve. I ngre lavdinë gjestit heroik të mësuesit atdhetar Haki Taha, dhe kujton se janë të shumtë ata Adem Jasharë që dhanë gjithçka patën për liri, pavarësi e bashkim kombëtar. Si ushtarak, atë dhe mua na trishton fakti se ende nuk po merret seriozisht domosdoshmëria e forcimit të mbrojtjes nëpërmjet rimëkëmbjes së ushtrisë tonë**

Shaban Murati që nuk resht së shkruari me guxim për qëndrimet që duhen mbajtur, nga shkrimtarja historiane Vilhelme Vranari, nga përfaqësuesi i shoqërisë civile Dashamir Uruçi, nga gazetarë si Xhevdet Mustafa, Genc Burimi, Kim Mehmeti, Fatos Lubonja, Selman Sheme, Engjëll Musai, Halil Rama, me shokë, deri tek i ndjeri Nazif Bezhani. Ndaj dhe qysh në faqen e parë, librin ia kushton kryeministrit të Kosovës Albin Kurti me fjalët: "...me urimin që të qëndrojnë deri në fund si shqiptar trim dhe i pathyer në mbrojtje të tërësisë tokësore, sovranitetit dhe dinjitetit të Kosovës, para presioneve djallëzore të diplomacisë ndërkombëtare që synon të plotësojë tekat e rrezikshme të kriminelëve serbë". Shpendi Topollaj i përshëndet me gjithë zemër aleancat, sidomos atë të përfshirjes së Shqipërisë në NATO. Madje, ai e quan fat për vendin e kombin tonë këtë.

Aleanca me ta është e domosdoshme, por kjo nuk do të thotë që Shqipëria të lerë në dorë të tyre sovranitetin dhe dinjitetin e vet. Sipas tij, në marrëdhëniet mes shteteve, duhet të prevalojë parimi i barazisë dhe reciprocitetit. Asnjë i huaj, kushdo qoftë ai, nuk ka të drejtë të bëjë ligjin në shtëpinë tonë. Asgjë nuk e përligj vartësinë e turpshme që çon edhe në konformimin me gjithçka ata sugjerojnë e urdhërojnë. Dhe janë disa analiza të fuqishme, ku ai u flet pa rezerva përfaqësuesve të vendeve të tjera, duke u kujtuar atyre se Shqipëria nuk është vend suzeren dhe asnjë ambasador nuk ka të drejtë të sillt te ne si guvernator. Sidomos, revolta e tij shtohet kur vjen puna te padrejtësitë e 1913 - ë s e në vazhdim, kur Shqipëria u coptua dhe nga trangu i atdheut u shkëput Kosova dhe Çamëria dhe që ende mbesin çështje të pazgjidhura, pasi edhe diplomacia e huaj asqë e përmend ndonjëherë. Ai shpreh mospajtimin e tij me qëndrimet e qeverisë tonë që edhe tani që Kosova ka fituar lirinë e pavarësinë e saj me gjakun e UÇK - së dhe luftën e forcave të NATO - s, manifeston kundërvënien ndaj veprimeve të qeverisë kosovare e cila nuk pranon të plotësojë tekat dhe kërkesat absurde dhe me pasojë të pariparueshme në të ardhmen nga ana e Aleksandar Vuçitit me atë asociacionin e tij dhelparak, i përkrahur për hir të koniukturave nga perëndimorët. Në një shkrim tjetër ai gati thërret: "Asnjë lëshim Serbisë!" Kosovën ai e sheh të pandarë

nga Shqipëria; prekja e interesave të saj është prekje e padiskutueshme e Shqipërisë. Nga ana tjetër, Shpendi është një admirues i padyshimtë i demokracisë amerikane dhe mirënjohës i asaj që ai vend ka bërë për ne, por në asnjë mënyrë nuk pranon ndërhyrjet paternaliste që mbjellin përçarje midis shqiptarëve. Për më tepër, ai paralajmëron se kjo mund të ketë pasojë shumë serioze në të ardhmen për ne. Vlen të përmendet për këtë shkrimin e tij "Askush nuk ka të drejtë t'i ngatërrojë më tej shqiptarët dhe të sillt si padroni i tyre" apo "Kam disa pyetje për ju zonja e nderuar ambasadore Juri Kim". Dhe mendoj se është një zgjedhje e zgjuar nga ana e këtij autori, kur thërret për ilustrim njerëz të shquar të Kombit tonë, pra të shqiptarisë, si Faik Konica e Naim Frashëri dhe të tjerë, çka duket te "Ç' do thosh sot Faik Konica" dhe "Naim Frashëri profet i bashkimit". Ja pse edhe shqetësimi i tij është pse intelektualët të paktën, heshtin. Sot jemi në kushte krejt të tjera, të favorshme për të folur pa drojë dhe gjithmonë në interes të atdheut në radhë të parë. Arsyetimet e tij janë të bazuara në llogjikën e rreptë të interesave kombëtare dhe e gjithë kjo e ngre atë në rangun e analistëve tanë më të mirë, të atyre që kombin e kanë të shenjtë, pa asnjë paramendim për përfitim. Shpendi, në pension prej më shumë se një dekade, nuk pret të bëjë karrierë. Atij i dhimbset fati i Kombit tonë të shumëvuajtur, dhe bashkimin e tij e sheh së pari te përpjekjet e vetë shqiptarëve. I ngre lavdinë gjestit heroik të mësuesit atdhetar Haki Taha, dhe kujton se janë të shumtë ata Adem Jasharë që dhanë gjithçka patën për liri, pavarësi e bashkim kombëtar. Si ushtarak, atë dhe mua na trishton fakti se ende nuk po merret seriozisht domosdoshmëria e forcimit të mbrojtjes nëpërmjet rimëkëmbjes së ushtrisë tonë. Dhe shqiptarët e sidomos intelektualët, pse jo edhe politikanët, duhet të ndërgjegjësohen për detyrat e tyre, edhe duke lexuar libra si ky, që e plotëson portretin e një shkrimtari të çuditshëm, si miku im i shtrenjë, atdhetari Shpendi Topollaj. Ndaj dhe me të drejtë Prof. Dr. Nuhi Vinca i drejtohet atij me fjalët: "sikur intelektualët tanë të kishin jo vetëm mençurinë, por edhe shqetësimin dhe kurajën për të folur ashtu si ti për çështjen kombëtare... realiteti do të ishte krejt tjetër".

STUDIMI

“NORA E MIRDITËS” QË I PREU KOKËN DJALIT TË BEGOLLIT

Nga Xhemal MEÇI

Mjeshtër i Madh

Prof. Selami Pulaha ka argumentuar se janë të njohura historikisht Kryengritjet antifeudale të shek XVI, -(Studime Historike, Tiranë, II, 1979, f. 197- 204), gjë që tregon se ngjarje të tilla kanë bazë historike, shkencore.

Sipas një legjende të njohur në Kelmend, Malësi e Madhe, aty nga mesi i shek. XVII vjen në Kelmend Pashai i Bosnjës për të nënshtruar vendin. Malësorët e Kelmendit i sillnin shumë dëme, duke i sulmuar karvanet në udhët tregtare e tjerë. Pashai erdhi me një ushtri të madhe dhe vuri shatoren e vet në një mesvendi, duke u kërkuar krerëve të vendit taksat dhe sigurinë e udhëve, ndryshe do të kryente sulme të rënda ndëshkimore. Paraprakisht kërkoi t'i sillnin në Shatore NORËN E BUKUR të Kelmendit. Krerët i kërkuan Nores t'i shkonte Pashait në Shatore dhe me bukurinë dhe zgjuarsinë e saj ta joshte aq sa të arrinte t'i priste kryet. Kështu do të shpëtonte Kelmendin dhe nderin e saj. Dhe, ashtu bëri Nora e bukur, trime dhe e mençur. (Injac Zamputi, - Fjalori Enciklopedik Shqiptar, VII, III, Tiranë, 2009, f.1852 - 1853).

Duke hulumtuar për traditën kanunore nëpër Mirditë gjatë viteve 1970 - 1980, u njoha me këtë kujtesë historike (Kodërspaç, 1980) të ngjashme me atë të Norës së Kelmendit, por që kishte ngjarë afro 150 vjet para Nores së Kelmendit. Megjithatë për ngjashmëri të ngjarjes mund ta quajmë “NORA E MIRDITËS”, por e njohur me emrin MARSHTERPA E SPAÇIT. (Në Spaç me fjalën shterp, kuptonin cucën, vajzën e virgjër). Krerët e vendit e bindën Marshterpën aso kohe, pra rreth mesit të shek. XVI, që të shkonte tek “Djali i Begollit” të Pejës që kërkonte nënshkrimin e vendit dhe një cucë si Ajo, i cili “ka rethuar Kodërspaçin, duke na kapur në befasi. Dhe tani që ta heqim qafet me gjithë ushtrinë e tij na duhet ndihma jote. Po arrite t'i presësh gërmazin, djelmnia e vendit atëhere do të sulmojë ushtrinë e tij, e cila e mbetur pa komandar, do të shpartallohet prej nesh. Kështu shpëton Spaçi e Mirdita mbarë, kurse ti do të këndohesh në kajkë për trimëninë, guximin dhe mençurinë tande. Hajt tash, e banu gati e na nxirë fitim e faqebardhë! Paq bekimin e ndihmën e ZOTIT, moj bijë!” Si dëgjoi me vemendje e urtësi u premtoi, se me ndihmën e Zotit do ta nderonte Spaçin, si cucë Mirdite se “Nuk më thonë kot Marshterpa e Spaçit!” Si u la e u shpërta, u vesh me rrobat e bukura të nusnisë mirditore, u lye me erza lulesh, të ruajtura enkas për raste të tilla, u paraqit gjithë dritë e aromë lulesh djalit të Begollit. E uroi, gjoja, për “mirseardhjen”, duke i thënë se do ta “festonin” këtë takim “të kandshëm” me shirup Mirdite, shumë i kandshëm e shumë i shëndetshëm. (Ishte i përgaditur me një llojë vene të amel, të cilit i fuste mjaltë herëpashere po edhe verë, që ia jepte me duart e bardha e gjithë naze e aromë lulesh, duke e joshur

• “N’ato lugje, n’ato shkrepë po vjen zani Marshterpa !”

Ndërsa **NORA LEGJENDARE E KELMENDIT** ishte e shek. XVII, “**NORA**” E MIRDITËS ishte rreth 150 vjet më përpara, por e mbetur në heshtjen e harresës. Po pse të mos e “ringjallim” sot, se siç thotë populli:” Më mirë vonë se kurr!”. Ky fakt është bërë i ditur te “**KANUNI i Lekë Dukagjinit**,”Varianti i Mirditës” (Tiranë, 2003 , Neni 180, f.95 dhe Shënimi 17, f. 247.)

XHEMAL RESHIT MEÇI
U lind në Kabash, lagje Meçe të Pukës, më 23 korrik 1936.



Ka mbaruar UT, fakulteti Gjuhë – Letërsi Shqipe 1967. Ka kumtuar në sesione, simpoziume, konferenca e kongrese shkencore lokale e kombëtare duke botuar artikuj shkencorë për etnologjinë, folklorin, gjuhën e historinë.

Është bashkëpunëtor shkencor i Institutit të Kulturës Popullore, të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë. Akademia e Shkencave, Tiranë, si edhe i sektorit Albanologjik të USH “L Gurakuqi” që në vitet '70.

Mban titullin e nderit “Mirënjohja e Qytetit të Pukës” dhe Urdhërin “Naim Frashëri” i Argjenditë.

“Xh. Meçi duke ecur në vazhden e Sh. Gjeçovit na dha përmbledhësen Kanuni i Lekë Dukagjinit në variantin e Mirditës, vepra më e arrirë shkencore në këtë fushë botimesh me interesa të gjëra kombëtare”.

Prof. Dr. Spiro Shkurti
(përgjegjës i sektorit të etnologjisë, Institutit i



me gjeste vallesh e buzëqeshje zanash, por me zemër që herë-herë i dridhej nga shpresa e guximi. Kështu djali i Begollit, i mahnitur nga ajo bukuri trupi e veshjeje nusërie mirditore, shoqëruar me naze “dashurore” dhe po aq ushqyer me pijen, “mushtin” e amel e të shijshëm si gjithçka brenda asaj çadre “xheneti”, aq sa pak nga pak filloi t'i vinte një gjumë ledhatues si kurrë ndonjëherë. Rojat jashtë çadrës gëzohehin ngaqë po gëzohej e çlodhej komandanti i tyre nga aq HARE E GËZIM, sa u hyri si një farë gjumi edhe atyre nga që vajza e bukur u jepte herëherë edhe atyre nga një tas asi shirupi. Si e kuptoi se tani ishte çasti më i volitshëm për t'ia lënë radhën thikës, me atë ia preu gërmazin deri në fund duke e mbytur në gjakun e tij, por menjëherë i hodhi mbi fëtyrë e gjoks shaminë e trashë e plot hijeshi, që e kishte mbajtur ngjeshur si përparce. Si u sigurua se çdo gjë po shkonte si e kishte menduar e vepruar, doli nga çadra duke i porositur rojat qetë- qetë, që të mos e trazonin deri sa të “çlodhej”, se po flente pak; ndërsa ajo do të ecte pak larg çadrës që të thithte ajrin e freskët të kësaj nate të paharrueshme. Pak më tej takoi “vëllezërit”, që po e prisnin plot ankth se si përfundoi “aksioni.” Si morën përgjigjen e “motrës Marshterp” u lshuan mbi rojet rrotull çadrës, të cilët i therën si kecat. Dhe pa vonuar u dha kushtrimi: “O moreee! Marshterpa, moreee! Bini burra mbi ta ! Bini burra , bre, binil!” Mbi tri kodrat ranë lodrat e kushtrimit. Për afro një orë u therën dhe u zunë robër të gjithë ushtarët armiq atë natë heroizmi mirditor. Nuk vonuan gra e burra të thurnin këngë për Marshterpën. Po Zef Gjokë DODA (1913 – 1996, burrë bujar e pleqnar i shquar) nuk mundi të kujtonte më shumë se ato dy vargje: “N’ato lugje , n’ato shkrepë/ po vjen zani Marshterpa”!, po ngjarjen e tregonte aq bukur, me ndjenjë e krenari”.

Mundet që mbas këtij shkrimi, studiuesit mirditas, që janë kërkues, hulumtues me plot botime të suksesshme, ta plotësojnë këtë ngjarje shumë interesante e domethënëse me burime të reja.